



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Kontabilitet
dhe Auditim”**

Universiteti Bujqësor i Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Rezarta Perri

Dr. Valbona Kapllani

Qershor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim"

1	IAL aplikues:	Universiteti Bujqësor i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 701, datë 19.10.2018.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 / PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 62 studentë; 2021-2022 55 studentë; 2022-2023 52 studentë.
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim" është hapur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 701, datë 19.10.2018 dhe ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Institucioni i Arsimit të Lartë, publik, " Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) u themelua në vitin 1951 si Instituti i Lartë Bujqësor në bazë të VKM Nr.548, date 28.07.1951, ndërsa në vitin 1991 iu ndryshua emërtimi në "Universiteti Bujqësor i Tiranës",

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 59, datë 16.12.2021 "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të Lartë Universiteti Bujqësor i Tiranës", me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 15.12.2026. Universiteti Bujqësor i Tiranës është i organizuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në gjashtë njësi kryesore:

- Fakulteti Bujqësisë dhe i Mjedisit;
- Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit;
- Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit;
- Fakulteti i Shkencave Pyjore;
- Fakulteti i Mjeksisë Veterinare;
- Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve.

Programi i studimit Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim" ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), që përbëhet nga 6 njësi bazë:

- Departamenti i Drejtim Agrobiznesit;
- Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural;
- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
- Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural;
- Departamenti i Matematikës dhe Informatikës;
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja;

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, pranë FEA është njësi bazë përgjegjëse që mbulon programin e studimit Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim". Programi i studimit Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim" është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e fushës së kontabilitetit dhe auditimit. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra), në përfundim të të cilit

studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim". Objektivi kryesor i këtij programi është arsimimi profesional dhe kualifikimi shkencor i studentëve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, përmes integritit të mësimin të njohurive themelore në këto fusha me praktikën. Gjithashtu, ky program studimi synon të sigurojë një nivel njohurish në fushën e kontabilitetit dhe auditimit të krahasueshëm me programet e studimit të nivelit master të institucioneve analoge ndërkombëtare.


PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 07.09.2022, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim". ASCAL bazuar në *"Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017"* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UBT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr. Rezarta Perri** dhe **Dr. Valbona Kapllani**, pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Majlinda Demirneli**.

Në datën 24.02.2023 ekspertëve të jashtëm iu dha në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 30 dhe 31 Mars 2023 në ambientet e UBT. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 19 Prill 2023. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master Profesional në "Kontabilitet dhe Auditim". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.


Universiteti Bujqësor i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26.05.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 38/50 Prot, datë 26.05.2023. Universiteti Bujqësor i Tiranës më datë 06.06.2023, njofton nëpërmjet sistemit AMS, me anë të shkresës me Nr.302/2 Prot, datë 05.06.2023 " Përcillen komentet mbi Draft Raportin", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Kontabilitet dhe Auditim”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm për këtë proces akreditimi të programit të studimit (në vazhdim të këtij raporti do i referohemi si GVJ) shqyrtoi përmbajtjen e dokumentave që janë pjesë e Dosjes së VetëVlerësimit (në vazhdim, RVB) për të gjykuar mbi shkallën e përmbushjes së kriterit 1 të këtij standardi. Sipas Statutit të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), neni 3, pika 2, vizioni i këtij institucioni është që për të tre ciklet e studimit: “të bëhet qendra ekselente më e madhe e ofrimit të shërbimeve universitare, trajnimit dhe kërkimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës”. Po kështu, në Planin Strategjik të Institucionit 2016 – 2025, pika 1.1 është formuluar qartë mënyra e jetësimit të vizionit afatgjatë të Institucionit duke integruar mësimdhënien, fushën kërkimore dhe përçimin e transferimin e dijeveve. Mënyra e formulimit të vizionit të Institucionit dhe fusha e programeve të studimit që ai ofron për të përgatitur specialistë të aftë për agromjedisin dhe ekonominë, si dhe menaxhimin e biznesit gjykohet nga GVJ se është në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore tradicionale kombëtare.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT).pdf; Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës, 2016-2025.pdf]</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Sipas Planit Strategjik të UBT, pika 1.1 dhe sipas Statutit të Institucionit neni 3, pika 2, misioni i këtij Institucioni është i shumëanshëm:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Zhvillimi, krijimi dhe transmetimi i dijeve përmes mësimdhënies;▪ Ndikimi pozitivisht në cilësinë e jetës në nivel kombëtar;



	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofrimi i mundësive për shoqërinë shqiptare për të përfituar nga arsimit në të gjitha fazat e jetës; ▪ Ndihma në zhvillimin e qëndrueshëm; ▪ Kontributi në rritjen e standardeve të qytetarisë dhe demokratizimit; <p>GVJ konstaton edhe se fusha e veprimtarisë së Institucionit është gjithashtu e larmishme duke filluar nga prodhimi bimor dhe shtazor, hortikultura, mbrojtja e bimëve, ekonomia agrare, bioteknologjia dhe ushqimi, menaxhimi i ndërmarrjeve, marketing, financë e kontabilitet, etj. (<i>Plani strategjik i UBT, pika 1.1 paragrafi 3</i>).</p> <p>Nga ana tjetër, sipas Rregullores së programit të studimit, Kreu II, neni 3, pika c, ky program synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit duke integruar mësimin me praktikën. Dhënia e njohurive në nivel të krahasueshëm me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare jashtë vendit është një tjetër synim i këtij programi studimi (<i>Rregullorja e programit të studimit, Kreu II, neni 3, pika d</i>).</p> <p>Duke gjykuar nga elementet e përfshirë në deklaratën e misionit të Institucionit, si edhe në fushat e veprimtarisë Institucionale, GVJ është i mendimit se programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” ofrohet në përmbushje të realizimit të misionit të plotë të institucionit dhe vjen në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranës (UBT).pdf; Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqesor te Tiranës, 2016-2025.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional ne Kontabilitet Auditim]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se ky program synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit duke integruar mësimin me praktikën si edhe duke i pajisur studentët me njohuri në nivel të krahasueshëm me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare jashtë vendit (<i>Rregullorja e programit të studimit, Kreu II, neni 3, pikat c dhe d</i>).</p> <p>GVJ vlerëson se këto synime të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT janë në zbatim</p>




	<p>të Planit strategjik, Statutit dhe Rregullore Institucionale sic referohen në kriteret e mësipërme duke mundësuar përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT).pdf; Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT).pdf; Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqesor te Tiranes, 2016-2025.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional ne Kontabilitet Auditim]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar Rregullore së programit të studimit, GVJ konstaton se është synim i Institucionit që të ofrojë njohuri të krahasueshme me institucione jashtë vendit dhe rrjedhimisht edhe brenda vendit, duke inkorporuar zhvillimet më të fundit globale në profesion. Në funksion të arritjes së këtij synimi, Institucioni ka hartuar edhe një Plan strategjik Kërkimi për periudhën 2016 – 2025, sipas të cilët, kërkimi shkencor paraqet një prioritet për integrimin e vendit në Bashkimin European, në përputhje kjo edhe me Strategjinë e Lisbonës për ta bërë BE-në ekonominë më konkurruese në botë. Plani Strategjik i Institucionit i përket viteve 2016 – 2025, pra një hark kohor i konsiderueshëm dhe gjatë të cilit kanë ndodhur përditësime të rëndësishme (sic është edhe miratimi i Strategjisë së re të Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë për vitet 2021 – 2025) dhe referuar deklarimeve të drejtuesve të Institucionit gjatë vizitës, është duke u hartuar një Plan i ri Strategjik i Përditësuar për Institucionin.</p> <p>Në propozimin për hapjen e programit të studimit, Institucioni paraqet argumenta se ky program është në funksion të zhvillimit të vendit si edhe prioriteteve ndërkombëtare në fushën e profesionit të kontabilistit dhe audituesit. Gjatë vizitës në Institucion, drejtues të tij si edhe pjesëtarë të stafit akademikë shprehën interesin e lartë të treguar për të ofruar një program studimi në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, si një ndër fushat me interesin më të lartë në punësim në vendin tonë.</p> <p>Në gjykimin e GVJ, përgatitja e profesionistëve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit e cila ka në fokus përparimin ekonomik në përgjithësi dhe, në mënyrë më të veçantë kontrollin dhe menaxhimin financiar si një ndër kapitujt e legjislacionit në</p>

	<p>përputhje me BE, ku vendi ynë është angazhuar gjatë viteve të fundit.</p> <p>[Referenca: Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës, 2016-2025.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në Kontabilitet Auditim; Aneks III.2 Propozim për hapjen e Programit MPKA në FEA pranë DFK.PDF]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Universiteti Bujqësor i Tiranës e ofron programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional në Kontabilitet & Auditim" në përputhje me misionin dhe qëllimin e deklaruar nga Institucioni në Statutin e tij. - Ky program studimi ofrohet në fushat e veprimtarisë së Institucionit dhe ka si synim ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. - PS paraqitet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe rregulloren e funksionimit të tij. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ shqyrtoi në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni dhe në mënyrë të veçantë Planin Strategjik të Kërkimit, Rregulloren e programit të studimit, Propozimin për hapjen e programit të studimit dhe dosjen e CV të profesorit të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>GVJ konstaton se UBT ka një historik të pasur dhe të larmishëm të aktiviteteve të tij akademike, mësimdhënëse dhe kërkuese të përshtatshme për ofrimin e një programi studimi të ciklit të dytë në Kontabilitet dhe Auditim nëpërmjet njësisë kryesore të tij Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, FEA. Profesori i angazhuar, si personeli akademik efektiv, ashtu edhe i jashtëm,</p>

	<p>janë me kualifikimet e duhura profesionale dhe shkencore në fushën e programit të studimit dhe janë emra të njohur të traditës së fushës kontabël në vend. UBT dhe FEA si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit kanë bashkëpunime domethënëse në fushën e kërkimit dhe projekteve shkencore duke ofruar terrenin e duhur për dhënien e njohurive të pasura dhe të ekuilibruara në kuadrin e këtij programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës, 2016-2025.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në Kontabilitet Auditim; Aneks III.2 Propozim për hapjen e Programit MPKA në FEA pranë DFK.PDF; Aneks III.3 CV-të e stafit akademik të angazhuar në DFK dhe MPKA.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”, ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, një nga njësitë kryesore të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Sic parashikohet në nenin 6 të rregullores së FEA, kjo njësi kryesore përbëhet nga 6 njësi bazë (departamente).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Drejtim Agrobiznesit; ▪ Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural; ▪ Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit; ▪ Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural; ▪ Departamenti i Matematikës dhe Informatikës; si dhe ▪ Departamenti i Gjuhëve të Huaja. <p>Fusha akademike dhe kërkimore e njësisë kryesore (FEA), sic përshkruhet në rregulloren e kësaj njësie, paraqitet në përputhje me fushën e programit të studimit pasi FEA është e fokusuar në shkencat ekonomike, pjesë e së cilës janë edhe kontabiliteti dhe auditimi.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në Kontabilitet Auditim; Aneks III.2 Propozim për hapjen e Programit MPKA në FEA pranë DFK.PDF]</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit</p>	<p>Sipas organizimit të njësisë kryesore të UBT që është përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, FEA ka gjashtë njësi bazë ose departamente. Njësi bazë, e cila është përgjegjëse për</p>

<p>duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>programin e studimit, është Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe programi i ofruar i studimit është në përputhje me orientimin akademik dhe kërkimor të njësisë bazë, sic edhe paraqitet në rregulloren e njësisë kryesore. Ky program studimi nuk është ndërdisiplinor.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit.PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional ne Kontabilitet Auditim; Aneks III.2 Propozim per hapjen e Programit MPKA ne FEA prane DFK.PDF]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Sic GVJ u shpreh në kriteret 2 dhe 3 të kësaj fushe, Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” është brenda profilit të institucionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Sic është shprehur në Statutin e organizimit të UBT, një nga qëllimet e aktivitetit të tij, përveç ofrimit të shërbimeve të arsimimit dhe kërkimit shkencor për studentët është edhe ofrimi dhe pajisja me dije gjatë gjithë jetës duke përfshirë ofrimin e kurseve të trajnimit pas diplomimit.</p> <p>Në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstatoi propozime të bëra nga ana e UBT për organizimin dhe ofrimin e kurseve të trajnimit me studentët e diplomuar të programit, në fushat e kontabilitetit dhe auditimit, që janë edhe fusha me interes në këndvështrimin e licencimit profesional. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, përfaqësues të stafit akademik dhe drejtues të Institucionit u shprehën se janë në proces të realizimit të kërkesave ligjore për ofrimin e këtyre kurseve, në bashkëpunim me Institucione të rëndësishme të fushës si Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, duke bërë që ky të jetë një kriter i plotësuar.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT).pdf; Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT).pdf; Aneks III.4 Propozim, Kurs trajnimi Kontabiliteti në Praktike.pdf]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>




	<p>- Programi i studimit "Master Profesional në Kontabilitet & Auditim", është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UBT, të njësisë kryesore FEA dhe të njësisë bazë, Departamentit të Financë-Kontabilitetit.</p> <p>- UBT dëshmon përpjekje edhe për ofrimin e trajnimeve gjatë gjithës jetës në fushat e kontabilitetit dhe auditimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Nga analiza e përmbajtjes së RVB, GVJ konstatohet procedura të shkruara për ndarjen e detyrave mes njësive përgjegjëse kryesore (FEA) dhe asaj bazë (Departamenti i Financë-Kontabilitetit). Gjithashtu u konstatuan procedura të shkruara të ndarjes së përgjegjësi me personelit të angazhuar për programin e studimit, qoftë akademik ashtu edhe jo akademik dhe administrativ. Institucioni ka hartuar rregullore të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë, ku detajohet çdo aspekt i nevojshëm si detyra, role, funksione të personelit, përgjegjësitë e tyre, etj. Në nenin 14 të Rregullores së FEA shihet gjithashtu se është bërë një parashikim i detajuar dhe i kujdesshëm i rolit të përgjegjësit të njësive bazë. Rolin e koordinatorit të programit të studimit e luan përgjegjësi i Grupit Mësimor Kërkimor (GMK) të Kontabilitetit (neni 4, Rregullorja e Programit të studimit), të cilat në FEA janë organizuar në mënyrë funksionale, sic GVJ dëshmoi edhe gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Në dosjen e RVB, GVJ hasi evidencë edhe në lidhje me kryerjen dhe raportimin e analizës së punës kërkimore dhe shkencore të njësive kryesore, FEA, për të tre vitet e marra në shqyrtim (2019 – 2020; 2020 – 2021; 2021 – 2022). Përveç analizës në raportet vjetore të njësive kryesore, RVB ka evidencë edhe për analiza të veprimtarisë mësimore edhe nga struktura si Drejtoria e</p>



	<p>Programve & Sigurimit të Cilësisë, Qendra e Kërkimit dhe Alumn-it. Në gjykimin e tij, GVJ vlerëson se analiza e kryer në nivel njësie kryesore, njësie bazë dhe programi studimi është e plotë dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranës (UBT).pdf; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.PDF; Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarisë mesimore dhe kërkimore periudha 2020-2021.PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional ne Kontabilitet Auditim; Info shtesë; 5. Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Tabelat 5.1 dhe 5.2 të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, RVB, kanë listuar marrëveshje bashkëpunimi mes UBT dhe 2 organizatave, 58 ndërmarrjeve dhe 2 Institucioneve në kuadrin e praktikave profesionale dhe 60 marrëveshje me universitete të huaja, 21 marrëveshje me universitete shqiptare dhe shqipfolëse, 45 marrëveshje me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit dhe 1 marrëveshje me institucion të qeverisjes vendore (bashki). GVJ shqyrtoi edhe dokumenta në RVB si raportin mbi nivelin e bashkëpunimit institucional, listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe listën e marrëveshjeve me organizata profesionale kontabël duke konstatuar një nivel të kënaqshëm të marrëveshjeve të lidhura dhe rezultateve të tyre. Duke qenë marrëveshje me partnerë nga bota e biznesit, autoritete ose ente shtetërore si edhe shoqata kontabiliteti dhe komitete kontabël e audituese me aktivitet në vendin tonë, GVJ është e mendimit se marrëveshjet ndihmojnë ndjeshëm Institucionin në arritjen e objektivave të procesit mësimor për këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.13 Raport mbi nivelin e bashkëpunimit Institucional te Universitetit Bujqesor te Tiranës,.PDF; Aneks I.14 Lista e marreveshjeve 2022 _ SHKFK dhe KKK.pdf; Aneks I.15 Lista e marrëveshjeve te bashkëpunimit QKA.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentave dhe tabelave shoqëruese të RVB u has evidencë për marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme në favor të realizimit të praktikave profesionale në funksion të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”. Këto institucione janë të</p>



<p>kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>larmishme si organe të qeverisjes vendore, shoqëri private, zyra kontabiliteti, organizata jo fitimprurëse etj. GVJ vlerëson se këto marrëveshje krijojnë kushte të favorshme për kryerjen e praktikave të studentëve dhe kjo u konfirmua edhe nga studentët e programit gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Në funksion të realizimit të kërkimit shkencor dhe për kryerjen e mobiliteteve për trajnim të stafit akademik dhe studentëve, të institucionit por edhe të programit specifik të studimit, GVJ konstaton bashkëpunimin me shumë universitete (të huaja dhe shqiptare, sipas tabelës 5.2 në RVB). Në gjykimin e GVJ këto marrëveshje garantojnë thellimin në kërkimin shkencor dhe kryerjen e mobiliteteve. Gjatë vizitës në Institucion, u mor informacioni se shumë nga personeli akademik i këtij programi ishin angazhuar më herët në marrëveshje mobiliteti me institucione të huaja.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.13 Raport mbi nivelin e bashkëpunimit Institucional te Universitetit Bujqesor te Tiranes,.PDF; Aneks I.14 Lista e marreveshjeve 2022 _ SHKFK dhe KKK.pdf; Aneks I.15 Lista e marrëveshjeve te bashkëpunimit QKA.pdf; Aneks II.2 Kerkesa dhe Kontrata per Praktike Profesionale ne MP, KA.PDF; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në Raportin e nivelit të bashkëpunimit institucional të UBT i hartuar në nëntor të vitit 2022, konstatohet kryerja e një analize të përbërjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe përfitimit prej tyre. Nga ky raport (faqja 9), GVJ konstaton se rreth 23% e të gjitha mobiliteteve të kryera në kuadrin e projekteve si Erasmus +, CEEPUS, etj, janë me destinacion FEA, që është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”.</p> <p>Pavarësisht se ky raport është hartuar në nivel institucional (UBT) dhe jo të njësisë apo programit të studimit, GVJ konstatoi se në të ka të dhëna të plota në lidhje me përfitimet që ka pasur njësia përgjegjëse (FEA) nga këto marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Përtej një dokumenti të posacëm të dedikuar për kryerjen e analizës së përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, GVJ ndeshi evidencë të kësaj analize edhe në raportet vjetore të analizës së veprimtarisë mësimore dhe shkencore të FEA sipas së</p>

	<p>cilave raportohen botime dhe kërkime shkencore të stafit akademik.</p> <p>[Referenca: Aneks I.13 Raport mbi nivelin e bashkëpunimit Institucional te Universitetit Bujqesor te Tiranes,.PDF; Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarise mesimore dhe kerkimore periudha 2020-2021.PDF]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione akademiko-kërkimore në vend por edhe të huaja. - UBT ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e praktikave profesionale me biznese, shoqata profesionale, si edhe organe të qeverisjes vendore. - Në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të UBT, FEA dhe Departamentit analizohen edhe rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit të angazhuar në këtë program studimi. 			
		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të	Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT (Tabela 9, RVB), GVJ konstaton se programet e studimit janë të organizuara në lëndë/module, të detyrueshme dhe me zgjedhje

<p>vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>dhe të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka në total 120 ECTS dhe paraqitet i organizuar në harmoni me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015.</p> <p>GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr 879 dhe VKM nr.185/2021. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, pra të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen secila me kredite, shpërndarja e të cilave mes kategorive respekton kërkesat ligjore në fuqi (<i>tabela 9 në RVB</i>). (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr 879, Tabela nr 1, në kategorinë A ku bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme duhet të ketë 5 – 10% të krediteve; në kategorinë B, që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të ketë 30 – 40% të krediteve në masterin profesional; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe duhet të ketë 20 – 30% të krediteve në masterin profesional; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmblyëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 20% të krediteve.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose</p>	<p>I shprehur në Rregulloren e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT (<i>neni 3, pika c</i>), synimi i këtij programi është arsimimi profesional dhe kualifikimi shkencor i studentëve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit si edhe sigurimi i njohurive themelore në këto fusha nëpërmjet integritetit të mësimin me praktikën.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit (<i>tabela 10, RVB</i>), GVJ konstaton se ky program përveçse përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, ofron mundësinë që studentët të angazhohen edhe në module studimi më të fokusuar brenda lëndëve të caktuara siç është p.sh., menaxhimi i qëndrueshëm i fermave, drejtimi i riskut financiar, biznesi ndërkombëtar dhe</p>

<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>tregtia ndërkombëtare. Ka gjithashtu lëndë që mbulojnë financën, kontabilitetin, auditimin, analizën, shërbimet e sigurisë dhe konsulencës, drejtimin fiskal, elemente formuese në fushën e sistemeve të informacionit kontabël, që, në gjykimin e GVJ ofrojnë në përgjithësi një formim të larmishëm dhe të pasur shumëdisiplinor për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Më tej, nga analiza që GVJ i bëri tërësisë së programeve lëndore (syllabuseve) të programit të studimit, konstatoi se ky program ofron për studentët mbulim kryesisht të mjaftueshëm dhe të kënaqshëm të një larmie njohurish teknike në fushat e kontabilitetit, auditimit dhe nënfushave të lidhura me to, si edhe anon drejt përgatitjes së profesionistëve me ndërthurje të parimeve akademike dhe njohurive praktike të disiplinës së kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p>Bazuar jo vetëm në analizën që GVJ i bëri dosjes së syllabuseve të lëndëve të programit, por edhe në diskutimet e përgjithshme të kryera gjatë vizitës në Institucion me pedagogët dhe studentët e programit të studimit, GVJ, në kuadrin e njohjes dhe eksperiencës së vet, formoi përshtypjen se gama e lëndëve të ofruara në këtë program studimi si edhe përmbajtja e syllabuseve të tyre mundësojnë ndërthurjen dhe integrimin e njohurive në mënyrë të tillë që, nga ana teknike, studentët të aftësohen e të përgatiten për t'u përballuar me kërkesat e tregut për këtë profesion. Vetë studentët shprehën besim për plotësinë e njohurive të marra prej tyre gjatë studimeve dhe të gatshëm të përballen edhe me situata të paparashikuara të cilat janë gjithmonë të pranishme në biznes.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në tabelat 9 dhe 10 të RVB (dhe në përputhje edhe me specifikimet e parashikuara në Rregulloren e Programit të Studimit), konstatohet se në Planin Mësimor të programit të studimit është specifikuar qartë se realizimi i praktikës mësimore është lëndë e kategorisë D, vlerësohet me 20 kredite (në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41) dhe realizohet në semestrin e katërt të studimeve. Detyrimet përmbyllëse, mikrotezë ose provim final në varësi të mesatares së studentëve,</p>



	<p>paraqesin detyrim të kategorisë E, vlerësohen me 10 kredite dhe kryhen në përfundim të semestrit të katërt të studimeve dhe pasi studenti ka plotësuar të gjitha detyrimet për shlyerjen e krediteve. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat përmbledhese të RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe</p>	<p>Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat</p>

<p>financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015.</p> <p>UBT nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.2 Propozim per hapjen e Programit MPKA ne FEA prane DFK.PDF]</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, në Statutin e UBT është e parashikuar që programet që ofrohen në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë të jenë të paktën 70% të ngjashme. Në dijeninë e GVJ dhe sa njihen prej saj programe të tjera të ngjashme, përmbajtja e planit mësimor të “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT është e ngjashme së paku 70% me programe me të njëjtin emër të ofruar në IAL të tjera në vendin tonë.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, ky program është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (shtojca 1, VKM 879); organizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale dy vite akademike me kohë të plotë, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.</p> <p>Sipas RVB për këtë kriter, dhe verifikuar nga GVJ edhe në shkresën e ardhur nga MASR, kodi unik i programit të studimit është BU3447211084.</p> <p>Me këtë kod, i cili është konform kuadrin ligjor përkatës (VKM nr 310/2022) lëshohen edhe diplomat e programit. Më tej në dosjen e syllabuseve, GVJ konstatoi se çdo lëndë e programit të studimit ishte e kodifikuar gjithashtu në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Info</i></p>

	<i>shtese 11. Vertetim mbi numrin unik te identifikimit MPKA (1).PDF]</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT nuk ofrohet në kuadrin e ndonjë bashkëpunimi të tillë pra ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. - Përmbajtja e planit mësimor është e ngjashme së paku 70% me programe me të njëjtin emër të ofruara në IAL të tjera në vendin tonë. - Programi i studimit jep njohuri në nivel të specializuar dhe të thelluar të kontabilitetit dhe auditimit, dhe nënfusha të lidhura me to, si dhe garanton punësimin dhe ekuivalentimin e transferimin e studimeve për studentët. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet	<p>Sipas dokumentave në RVB, në 16/12/2021, me Vendimin nr. 59 të Bordit të Akreditimit, UBT është akredituar në nivel Institucional për pesë vite duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit i cili, duke qenë i</p>

akademike vlerësimin dhe akreditimin.

organizuar në 6 departamente si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente.

- Departamenti i Drejtim Agrobiznesit;
- Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural;
- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
- Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural;
- Departamenti i Matematikës dhe Informatikës; si dhe
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja.

FEA ofron gjithsej 21 programe studimi (*tabela 3 në anekset e RVB*): 2 programe studimi profesionale jo universitare; 6 programe studimi në nivelin bachelor, 5 programe studimi në Master i Shkencave, 6 programe studimi në Master Profesional, 1 program studimi Master Ekzekutiv dhe 1 program doktorature.

Njësia bazë që ofron programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” është Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe sipas tabelës 3 në RVB, kjo njësi bazë ofron gjithsej 4 programe studimi: 1 program studimi në nivelin bachelor, 1 program studimi në Master i Shkencave, dhe 2 programe studimi në Master Profesional.

Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” është hapur me urdhër të MASR nr. 701 më 19/10/2018 dhe i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë. Ky program ofrohet në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë 85/2015 në dy vite akademike dhe ka 120 ECTS.

GVJ konstaton se ky departament përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (më specifikisht, ka minimumi 7 pedagogë akademikë efektivë nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada). Bazuar në informacionin e marrë në RVB dhe nga konfirmimi gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidenton se Departamenti Financë-Kontabilitetit organizohet në dy grupe mësimore ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga përgjegjësit e gruplëndëve (Grupe Mësimore Kërkimore – GMK). GMK financë ka 11 anëtarë dhe GMK kontabilitet ka 6 anëtarë. Drejtuesit e GMK raportohen në tabelat e RVB.

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (89 pedagogë PAE) dhe 71 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë (Të dhëna të përpunuara nga gjetjet në DVV, viti akademik 2022-2023)

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	13	4
Prof.Asoc	32	3
Dr/PhD	32	18
Dr në proc	11	1
Msc	1	45
Gjithsej	89	71

Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezultojnë se çdo njësi bazë e FEA plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor.

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	4	3
Prof.Asoc	5	1
Dr/PhD	7	5
Dr në proc	1	-
Msc	-	10
Gjithsej	17	19

Nga tabela 6.1-6.3 në RVB konstatohet se në programin e studimit "Master Profesional në Kontabilitet & Auditim" janë angazhuar si staf akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), si më poshtë në tre vitet e fundit akademike:

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	5	2	4	3	2	3
Prof. Asoc.	6	-	7	-	8	-

Dr/Phd	5	3	4	2	4	2
Msc.	0	-	-	-	-	-
Gjithsej	16	5	15	5	14	5

Bie në sy se në të tre vitet e raportuara më lart raporti PAE / PAK për programin e studimit është më shumë se 75% / 25% duke përbushur kështu kriteret e kërkuara. Shihet gjithashtu se në këtë program studimi nuk është angazhuar asnjë pedagog me kualifikim më të ulët se Doktor i Shkencave duke plotësuar gjithashtu kërkesat ligjore në fuqi.

[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.9 Certifikata e Akreditimit të UBT.pdf; Aneks IV. Tabelat përmbledhese të RVB-se (1-22).pdf]

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Nga shqyrtimi i tabelave të RVB, konstatohet se çdo njësi bazë e FEA ka të paktën një personel ndihmës akademik / administrativ (PNA) të angazhuar. Edhe Departamenti Financë Kontabilitet që është njësi bazë që ofron programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”, ka një PNA të angazhuar. Pika 7, neni 4 i rregullores për rekrutimin e PNA përshkruan detyrat e këtij stafi. Personeli Ndhmës akademik, PNA pra është në nivel departamenti, njësi bazë dhe ndihmon në koordinimin e detyrave edhe për këtë program studimi.

Mbështetur në konfirmimet e marra gjatë vizitës në institucion, programi i studimit kishte orë laboratorike në lëndë si Sistemet e Informacionit në Kontabilitet pavarësisht se në Planin Mësimor të programit këto trajtohen si seminare. Sipas RVB, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë programet financiare (si psh. Financa 5) në 2 prej laboratorëve të FEA-s. Ky fakt u vërtetua nga GVJ edhe gjatë vizitës në Institutin. GVJ gjykon se angazhimi i studentëve në orë laboratorike në funksion të arritjes së objektivave mësimore është vlerështues për programin e studimit dhe vetë studentët u shprehën se praktika në orë laboratorike në programin financiar ishte ndihmë për t’i aftësuar ata për tregun e punës.

[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.5. Rregullore për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndhmës dhe Administrativ, UBT, Dhjetor 2018.pdf; Aneks IV. Tabelat përmbledhese të RVB-se (1-22).pdf; Info shtese 10. Rregullore Për procedurat e rekrutimit



	<i>per personelin akademik, ndihmes-akademik dhe administrative ne UBT.pdf</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Sipas nenit 4, pika c e Rregullores së Programit të studimit, koordinatori i “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” është përgjegjësi i grupit mësimor kërkimor të kontabilitetit pranë DFK. Neni 15 i rregullores së UBT e parashikon organizimin e njësive bazë në grupe mësimore kërkimore dhe raportimet e Institucionit në tabelat e RVB konstatojnë caktimin e këtyre grupeve si edhe drejtuesit e tyre. Detyrat e koordinatorit të programit të studimit, duke qenë kryetari i GMK përkatës mund të gjenden në Rregulloren e njësisë bazë dhe sipas RVB përmbledhen në monitorimin e ecurisë së proceseve mësimore, ruajtja e cilësisë dhe e disiplinës, koordinimi dhe mbarëvajtja e orarit dhe ndjekja e procesit mësimor në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranës (UBT.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Info shtese 6. Rregullore e Brendshme e Departamentin FK.PDF]</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia kryesore FEA dhe njësia bazë DFK që janë përgjegjës për ofrimin e programit të studimit përmbushin standardet ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive.</i> - <i>FEA dhe DFK kanë personel ndihmës akademik të angazhuar në ndjekjen e praktikave dhe orëve laboratorike për aq sa janë të nevojshme dhe të parashikuara në programin e studimit.</i> - <i>Programi i studimit ka një koordinator i cili është njëkohësisht drejtuesi i GMK përkatëse, detyrat e të cilit garantojnë mbarëvajtjen e rregullt të aktiviteteve në këtë program.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në RVB si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit (Plani Mësimor i Programit të Studimit, udhëzime për studentët, etj) dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT disponohen nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (njësia kryesore) dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit (njësia bazë) si edhe elementet kryesore të tyre janë publike dhe të mundshme për t’u aksesuar lirisht.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; https://www.ubt.edu.al/fea]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit (<i>kreu III, neni 5</i>), GVJ konstaton se organizimi i veprimtarisë mësimore vjetore të Programit të Studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT shtrihet në dy vite akademike me katër semestra që kanë kohëzgjatje normale 15 javë. Lëndët janë të kodifikuara dhe të vlerësuara me kredite sipas sistemit europian, ECTS.</p> <p>Sipas Planit mësimor të programit të studimit (<i>tabela 10 në RVB</i>) në semestrin e parë, të dytë dhe të tretë akademik ofrohen 6 lëndë me nga 5 ECTS secila, pra 30 ECTS në total për çdo semestër dhe 60 ECTS në total për vitin; një ndër lëndët është lëndë me zgjedhje për çdo semestër. Në semestrin e katërt janë parashikuar kryerja e praktikës mësimore me 20 ECTS dhe mikroteza ose provimi final me 10 ECTS. Plani mësimor përmban informacion të plotë në lidhje me orët në auditor dhe jashtë auditorit për çdo lëndë. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se për vitin e fundit akademik (2022 – 2023) mësimi ishte i organizuar gjatë fundjavave për të plotësuar kërkesat e studentëve, por duke respektuar ndarjen e lëndëve në semestra sipas Planit Mësimor të miratuar. Përsa i përket elementeve të tjera si frekuentimi dhe kërkesat për ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, vërejmë se Institucioni i specifikon ato në rregulloren e</p>

	<p>programit të studimit, si edhe i përsërit në programet lëndore të çdo lënde. Rregullat për nivelin e frekuentimit të mësimit në rastin e programeve të ciklit të dytë specifikohen në rregulloren e programit të studimit. Ndërsa në programet lëndore specifikohet masa e frekuentimit në auditor për çdo element studimi. Në këtë program studimi frekuentimi i orëve ishte i detyruar në masën 80%.</p> <p>Format e kontrollit të njohurive, sipas rregullores së programit, janë të shtrira në mënyrë të vazhduar gjatë gjithë vitit dhe në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur edhe në tabelat në anekset e RVB:</p> <table border="0"> <tr> <td>▪ Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>▪ Plotësimi i detyrimeve</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>▪ Testimet gjatë vitit</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>▪ Provimi përfundimtar</td> <td>60%</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>100%</td> </tr> </table> <p>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</p>	▪ Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%	▪ Plotësimi i detyrimeve	10%	▪ Testimet gjatë vitit	20%	▪ Provimi përfundimtar	60%	Totali	100%
▪ Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%										
▪ Plotësimi i detyrimeve	10%										
▪ Testimet gjatë vitit	20%										
▪ Provimi përfundimtar	60%										
Totali	100%										
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi Rregulloren e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, <i>kreu III</i>, konstatoi se ajo përmban detajet e nevojshme mbi kushtet, kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen për t’u pranuar në programin e studimit (<i>neni 9</i>). Kjo rregullore përcakton edhe procedurat dhe kriteret për transferimin (<i>neni 41, 42 dhe 43</i>) dhe ekuivalentimin e studimeve (<i>neni 44</i>).</p> <p>Në “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” kanë të drejtë të aplikojnë individë që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “Bachelor” në sistemin me kohë të plotë ose të pjesshme dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme të cilat rishikohen për çdo vit akademik (GVJ hasi evidencë edhe për propozimin e kritereve vjetore gjatë vizitës në Institucion):</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kriteri i meritës – nota mesatare e ponderuar e nivelit bachelor, 										

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kriteri i rëndësishëm – koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të departamentit. ▪ Kriteri i kuotave të programit. <p>Në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe rregulloreve të UBT, FEA dhe të programit të studimit. Transferimet lejohen brenda të njëjti cikël studimi e në fusha të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik (<i>Rregullorja e programit, neni 41</i>). Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet në hyrje i takon komisionit të posaçëm të ngritur nga FEA. Procedurat për transferimin në hyrje dhe dokumentat që duhet të dorëzohen përshkruhen me detaje në rregulloren e programit të studimit. Rregullorja e programit të studimit parashikon edhe procedurat për ekuivalentimin e programeve të studimeve. Ekuivalentimi bëhet i plotë ose i pjesshëm në përputhje me Statutin e UBT. Pranë FEA dhe me urdhër të Dekanit të Fakultetit ngrihen komisionet ad hoc të njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve. Komisionet përbëhen nga tre anëtarë: Zv dekanit për mësimin dhe kurrikulat i cili është edhe kryetar i komisionit, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i grupit mësimor, kjo në varësi të programit që kërkohet të ekuivalentohet. Rregullat e ekuivalentimit përshkruhen me hollësi në Rregulloren e programit të studimit. GVJ konstaton që programi i studimit ka pasur 2 transferime në hyrje në vitin akademik 2021 – 2022.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.15 Propozim i kritereve për pranimin e studenteve BCH dhe MP 2020-2023.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks IV. Tabelat përmbledhese të RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar jo vetëm Planin Mësimor që është pjesë e tabelave të RVB, por edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT të cilat janë pjesë e RVB. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me leksionet, praktikant në auditor dhe seminarët në përputhje kjo me VKM nr. 41 si edhe mënyrën e vlerësimit që ndiqet në çdo</p>

<p>komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>lëndë. Komponentët formues të programit të studimit janë formuluar në syllabuse konform formateve të kërkuara sipas VKM nr. 41 të përditësuar nga VKM nr. 879.</p> <p>Sipas tabelës nr. 14 në RVB dhe konfirmuar nga GVJ edhe në programet lëndore, nota përfundimtare e studentit në “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT është rezultante e këtyre elementëve të vlerësimit: ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në procesin mësimor, plotësimi i detyrimeve laboratorike dhe i detyrave të kursit që ishin të pranishme për çdo lëndë, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar. Përqindja e rëndësisë për çdo komponent vlerësimi është e përcaktuar në çdo syllabus konform edhe parashikimeve të nenit nr. 26 të rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Për t’u shprehur në lidhje me shkallën e plotësimit të këtij kriteri, GVJ shqyrtoi Rregulloren e Planit Mësimor ku në <i>nenin 18</i> pika 2 dhe 3 gjeti të shprehur rishikimin e përmbajtjes së planit mësimor të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në fillim të çdo viti akademik me qëllim përmirësimin e tij. Kjo praktikë konfirmohet si procedurë e parashikuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore, FEA (<i>neni 20, pika 3</i>) sipas së cilës modulet mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në programet e studimeve dhe kreditet për secilën prej tyre mund të rishikohen. Ndryshimet propozohen nga departamenti përkatës duke ndjekur instancat deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UBT në rastin kur masat e ndryshimit të kërkuar nuk kalojnë nivelin 20%.</p> <p>Në pikën 1.3 të dokumentit që analizon punën kërkimore dhe shkencore të njësisë kryesore u gjet evidencë për analizën reale të kryer nga ana e njësisë kryesore dhe asaj bazë. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ gjithashtu pyeti stafin e angazhuar në programin e studimit dhe konfirmon ndjekjen e procedurës së parashikuar për përmirësimin e përmbajtjes së programit.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesi.PDF; Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarise mesimore dhe kerkimore periudha 2020-2021.PDF;</i></p>

	<i>Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; vizita ne institucion]</i>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Program i studimit Master Profesional në Kontabilitet & Auditim, paraqitet i detajuar me elementet përkatëse të kërkuara në kuadrin ligjor dhe është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë sipas Kornizës 7. - Kuadri rregullator i UBT parashikon kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. - Programi i studimit i nënshtrohet përmirësimeve të vazhdueshme të përmbajtjes së tij duke reflektuar komentet e studentëve të programit por edhe iniciativat e pedagogëve të angazhuar në program. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT dhe përmbajtjes së Planit Mësimor në tabelat e RVB, nga GVJ u konstatua se programi i studimit parashikon lëndë të ndryshme të formimit të nevojshëm profesional dhe njohuri në disiplina të lidhura me kontabilitetin dhe auditimin. Përmbajtja e përgjithshme e veprimtarive të parashikuara në çdo lëndë, sikurse gjykohet nga GVJ duket se mundëson formimin teorik dhe praktik të nevojshëm të studentëve në funksion të punësimit të tyre. Edhe vetë studentët e programit u shprehën se njohuritë e marra në auditor i kanë ndihmuar të përshtaten me vendet e punës.

	<p>Gjithashtu, nga sa GVJ ka njohuri për përmbajtjen e programeve të studimit të ngjashme të ofruara në Institucione të tjera, përmbajtja e Programit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT me këto programe të tjera është e tillë që garanton studime të mëtejshme të thelluara në fushën e kontabilitetit dhe / ose auditimit nëse studenti vendos të thellojë njohuritë e tij në këto fusha.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit që është pjesë e RVB, si edhe nga shqyrtimi i objektivave formuese të çdo lënde në syllabuset përkatëse, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy semestrat sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e mirmenduar, e balancuar dhe mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese të programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. (GVJ konfirmon se misioni dhe objektivat e këtij programi studimi specifik gjenden në rregulloren e programit të studimit neni 7, si dhe përforcohen në programet e veçanta lëndore, kurse rezultatet e pritshme të të nxënit theksohen në mënyrë të detajuar dhe të plotë në programet lëndore). GVJ vlerëson se organizimi i lëndëve sipas semestrave garanton marrjen e njohurive sipas një radhe logjike dhe që mundëson ndërtimin e një themeli të mirë njohurish në kontabilitet dhe auditim si edhe në nënfusha të lidhur me to si fiskalitetet, drejtimi financiar, etj.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat në anekset e RVB (<i>specifikisht tabela 10</i>), sktrukturën mësimore dhe kurrikulën e çdo periudhe të përfshirë në procesin e akreditimit, si edhe programet lëndore të lëndëve të ofruara në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, konfirmon se këto lëndë ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. Emërtimi i tyre paraqet ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline, sipas</p>

<p>studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>njohjes që anëtarët e GVJ kanë me programe studimi ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit.</p> <p>Studentët që u intervistuan gjatë vizitës në Institucion u shprehën në përgjithësi të kënaqur me lëndët e ofruara nga programi dhe u shprehën se ato plotësojnë nevojat për informacion të programit dhe se ata ndjehen të kompletuar në njohuritë që marrin. GVJ vlerëson se njohuritë e ofruara në këtë program masteri profesional u japin studentëve aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit. Lëndë si kontabiliteti i avancuar, auditimi, standardet e raportimit financiar sigurojnë kuadrin e njohurive themelore në profesion, kurse lëndë si Etika në Biznes, Sistemet e Informacionit në Kontabilitet, u japin studentëve aftësi dhe kompetenca për të ushtruar aftësitë teknike të tyre në mënyrë konkurruese me pritshmëritë e tregut vendas dhe ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.4.1-3 Struktura mesimore dhe Kurikula 2019-2022.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita ne institucion]</i></p>										
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket strukturës së programit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, dhe ndarjen në total në veprimtari formuese, GVJ ndeshi informacion të përmbledhur në tabelën 12 të RVB:</p> <table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Leksione</td> <td style="text-align: right;">540 orë</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Seminare</td> <td style="text-align: right;">540 orë</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Praktikë profesionale</td> <td style="text-align: right;">500 orë</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 20px;">▪ Diploma/ Provim Formimi</td> <td style="text-align: right;">250 orë</td> </tr> <tr> <td style="padding-left: 40px;">Totali</td> <td style="text-align: right;">1'830 orë</td> </tr> </table> <p>Raporti Teori (leksione) / Praktikë (seminare & praktikë profesionale) rezulton 540 orë teori / 1040 orë praktikë ose afërsisht 34% / 66%.</p> <p>Sipas raporteve të mësipërme mes veprimtarive formuese, vihet re një theksim i shtuar ndaj elementeve praktike të programit të studimit, çka në gjykimin e GVJ mundëson formimin praktik dhe jo vetëm të studentëve. Me njohuritë e marra, studentët mund të kryejnë mobilitete, të transferojnë studimet dhe të punësohen në fusha si kontabiliteti dhe auditimi dhe nënfusha të përafërta me to.</p>	▪ Leksione	540 orë	▪ Seminare	540 orë	▪ Praktikë profesionale	500 orë	▪ Diploma/ Provim Formimi	250 orë	Totali	1'830 orë
▪ Leksione	540 orë										
▪ Seminare	540 orë										
▪ Praktikë profesionale	500 orë										
▪ Diploma/ Provim Formimi	250 orë										
Totali	1'830 orë										


	<i>[Referenca: Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Siç GVJ u shpreh edhe në kriterin II.3.5 më lart, përmirësimi i syllabuseve është një praktikë e parashikuar në rregulloren e njësisë kryesore (FEA) që ofron programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, si edhe në rregulloren e programit të studimit (<i>neni 57</i>). Sipas kësaj të fundit, FEA dhe DFK në fund të çdo viti akademik angazhohen në rishikimin periodik të programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit aktivizon komisionin ad hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe është përgjegjës për këtë proces. Rishikimi fokusohet në shpërndarjen e krediteve, përmirësimin e programit lëndor të moduleve të vecanta, rishikimi i bazës didaktike, i literaturës, etj. Procesi i rishikimit konsideron edhe feedback të marrë nga ana e studentëve nëpërmjet pyetësorëve të realizuar me ta në fund të procesit mësimor, dhe iniciativat e vetë pedagogëve të lëndës të cilët, sipas kësaj rregulloreje, japin një relacion me shkrim për të gjitha aspektet e organizimit të mësimdhënies për modulet përkatëse.</p> <p>Në vijim të analizës së rregulloreve, nga shqyrtimi më i detajuar që GVJ u bëri përmbajtjes së dosjes së syllabuseve, u konstatua se këto syllabuse në përgjithësi garantojnë marrjen e aftësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës për profesionistë kontabël dhe auditues të brendshëm dhe të jashtëm. Gjithashtu, literatura bazë dhe ndihmëse ishte përgjithësiht e përditësuar dhe e shkruar nga autorë të respektuar të fushës duke mundësuar marrjen e njohurive kyce në kontabilitet dhe auditim dhe nënfushat e lidhura me to.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf]</i></p>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri Planit Mësimor dhe programeve lëndore të programit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, përmbajtja e tyre në përgjithësi mundëson përfitim të dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave të synuara siç edhe janë formuluar në <i>pikën 3 të nenit 7</i> të Rregullores së programit të studimit.</p> <p>Studentët mund të pajisen me njohuri teorike dhe praktike në sistemet e informacionit kontabël, kontabiliteti i avancuar</p>

	<p>financiar, i kostos dhe i drejtimit, raportim financiar dhe analizë e thelluar e kostove dhe e pasqyrave financiare, auditim i brendshëm dhe vlerësimi i ndërmarrjeve, adminstrimi fiskal dhe kontabiliteti bankar, shërbimet e sigurisë dhe konsulencës, etj. GVJ vlerëson se në mënyrën e organizimit të tij dhe ashtu si u përcillet studentëve, programi “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” garanton përfundimin e njohurive të synuara.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT dhe syllabuseve, GVJ konstaton se ky program mundëson edhe vijimin e mëtejshëm të studimeve në programe të tjera të ciklit të dytë, edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës për profesionistë të pavarur ose punonjës në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Pajisja e studentëve me njohuri në kontabilitet, auditim, drejtim dhe kontroll financiar, programe informacioni në kontabilitet është në përputhje me kërkesat e tregut të punës për këtë profesion (në dijeni të GVJ) dhe ndihmon njësitë ekonomike duke iu ofruar atyre profesionistë të përgatitur në këto disiplina.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Struktura e programit të studimit Master Profesional në Kontabilitet & Auditim, lëndët dhe emërtimi i tyre, shpërndarja mes veprimtarive formuese dhe ngarkesa në kredite janë në përputhje me profilin e programit master në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, si dhe të ngjashme me programe të të njëjtit profil në nivel kombëtar e më gjerë.</i> - <i>Tërësia e njohurive të ofruara në programin e studimit plotëson synimet e programit dhe përgatit studentë të aftë në profesion, por edhe të aftë për të vazhduar studime të mëtejshme të thelluara.</i>



	- Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së programit garanton përditësimin në favor të rritjes së cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Sic argumentohet në RVB të përgatitur nga Institucioni dhe nga deklarata të drejtuesve të Institucionit gjatë vizitës, hapja e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” justifikohet me kërkesën në rritje të studentëve të diplomuar në nivelin Bachelor në të njëjtin Institucion, por edhe nga kërkesa të ardhura nga të tjerë studentë. Sipas dokumentacionit të RVB dhe të shqyrtuar në mënyrë të detajuar nga GVJ, UBT ka kryer një studim të tregut të punës pas hapjes së programit të studimit (në vitin 2022).</p> <p>Institucioni gjithashtu duket se arrin të shfrytëzojë marrëveshjet e bashkëpunimit për të mbajtur kontakte me tregun e punës dhe për të reflektuar nevojat e tyre me njohuri dhe kompetenca që duhen përçar tek studentët e programit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”. Në RVB gjendet edhe një raport mbi nivelin e bashkëpunimit institucional mes UBT dhe partnerëve të tij. Gjatë vizitës në Institucion, drejtues të tij u shprehën për GVJ se ata marrin parasysh propozime të partnerëve nga tregu profesional, kryesisht gjatë eventeve të tilla si leksione të hapura, panairi i karrierës, etj, pa i formalizuar opinione të tilla në një studim të mirëfilltë nga tregu i punës.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.13 Raport mbi nivelin e bashkëpunimit Institucional te Universitetit Bujqesor te Tiranes.PDF; Aneks I.15 Lista e marrëveshjeve te bashkëpunimit QKA.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, UBT garanton pjesëmarrjen e studentëve në procesin e përmirësimit të</p>




<p>studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>programit të studimit dhe i konsideron këta të fundit si një burim të rëndësishëm informacioni për përmirësim. Opinioni i studentëve merret nëpërmjet instrumenteve si pyetësorët e drejtuar tek ata, opinionet e përmbledhura nëpërmjet Këshillave Studentorë, studentëve të përfshirë në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Komisionit për programet e studimit dhe kërkimin shkencor. GVJ konstatoi se edhe në Manualin e Cilësisë të UBT (viti 2018) ku parashikohet procedura e përmirësimit të përgjithshëm të kurrikulave dhe ku theksohet se në përbërje të Komisioneve që do të ngrihen për këtë qëllim duhet të ketë edhe përfaqësues të këshillave studentorë dhe të botës së biznesit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.16. Manual i cilesise, UBT 2018.PDF; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Sipas RVB, të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, lexojmë se disa prej profesorëve të angazhuar në këtë program studimi janë anëtarë të shoqatave të kontabilitetit dhe auditimit, si Instituti i Ekspertëve Kontabël, Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë si edhe institucioneve me rëndësi në vendin tonë në këtë fushë, si Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Gjithashtu, siç GVJ konstaton nga dosja e CV e stafit të angazhuar në këtë program studimi, një pjesë e mirë e PAE janë profesionistë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p>GVJ vlerëson dosjen e pasur të UBT dhe FEA-s për projekte të lidhura direkt me fushën e raportimit financiar, kontabilitetit dhe auditimit (REPARIS), nga të cilat kanë përfituar stafet akademike të këtij programi. Eksperienca e përftuar nga stafi nga projektet apo bashkëpunimi me bizneset dhe industrinë gjenden të reflektuara në programet lëndore të ofruara në këtë program.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.3 CV-të e stafit akademik të angazhuar në DFK dhe MPKA.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT është i angazhuar në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke reflektuar opinione të paleve të përfshira, si studentet dhe institucionet partnere. - Personeli i angazhuar në këtë program, projektet ku ata marrin pjesë, bashkëpunimet me aktorë të botës së biznesit dhe



	<i>angazhimi i studentëve në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm garantojnë një proces serioz dhe cilësor të trajtimit të kurrikulave të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Sic mund të konstatohet në Rregulloren e Programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” të UBT, qëllimi i këtij programi është të formojë një profil specialisti që të jetë i aftë të kryejë kontabilizimin e transaksioneve dhe auditimin e pasqyrave financiare brenda një kuadri teorik cilësor dhe sasior; pajisja e specialistëve me instrumentat dhe teknikat më bashkëkohore. GVJ gjykon se këto objektiva të programit janë në përputhje me prioritetet dhe objektivat madhorë të Institucionit siç përcaktohen në statutin e UBT, për ofrimin e shërbimeve cilësore në edukim dhe kërkim shkencor dhe për atë sa kërkimi shkencor është i nevojshëm për një program studimi profesional në ciklin e dytë (studimi i tregut të punës).</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT).pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks III.12 Studim tregu i punës MPKA.pdf]</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga shqyrtimi i neneve të Statutit dhe rregulloreve të UBT në nivel universiteti, njësie kryesore dhe program studimi, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit si njësi kryesore dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësi bazë që ofrojnë programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” kanë të parashikuara bashkërendimin e veprimtarive mësimore dhe shkencore duke garantuar respektimin e lirisë akademike të personelit. Fryma pozitive e bashkëpunimit mes stafit, e lirisë dhe fleksibilitetit të tyre në organizimin e aktiviteve mësimore dhe kërkimore u konfirmua

	<p>edhe gjatë vizitës në Institucion me stafin pedagogjik të pranishëm gjatë vizitës.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT).pdf; Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT).pdf; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit.PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga RVB, GVJ informohet se njësia bazë që ofron programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”, Departamenti Financë-Kontabilitetit vazhdimisht nxit studentët të angazhohen në studime dhe projekte kërkimore duke përmendur konferencat e organizuara në këtë institucion. Siç GVJ e konfirmon, nxitja dhe motivimi i studentëve për t’u angazhuar në projekte kërkimore është parashikuar edhe në rregulloren e programit të studimit (<i>neni 18 pika 2.c</i>) sipas së cilës është parashikuar përfshirja e detyrave të kursit në çdo lëndë.</p> <p>Evidencë u ndesh edhe për organizimin e konferencave studentore ku nga axhenda e konferencës (<i>pjesë e RVB</i>) duket qartë përfshirja e studentëve të këtij programi studimi si referues në aktivitet. Gjatë vizitës në Institucioni, ekspertët u njohën me materiale që dëshmonin angazhimin e studentëve në konferenca shkencore (<i>botimi i konferencës</i>) ku vetë studentët mund të merrnin pjesë me tarifa të zeruara. Bazuar në këto konstatime, GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (I-22).pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter përmenden një sërë elementësh për të justifikuar mbështetjen financiare të njësisë bazë (DFK) nga Institucioni për realizimin e aktiviteteve kërkimore, studimore dhe shkencore. Këto elemente u mbështetën edhe nga stafi akademik gjatë vizitës në Institucion dhe u konfirmuan edhe nga drejtues të UBT.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbështetja financiare për botimin e artikujve shkencorë me faktorë impakti në Scopus ose WES (nga viti 2022 e në vazhdim).




	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Botimi i artikujve në revistën shkencore të FEA është falas për stafin PAE. ▪ Përjashtimi nga tarifa e shkollës së doktoraturës e stafit pedagogjik të brendshëm të institucionit. ▪ Financimi i projekteve kërkimore shkencore nga UBT për të gjithë stafin duke filluar nga viti financiar 2023 (më herët ka qenë vetëm për doktorantët). ▪ Mobilitetet në kuadrin e projekteve Erasmus + për stafin doktor në proces. <p>Nëpërmjet shqyrtimit të relacionit për realizimin e buxhetit (viti financiar 2021), GVJ konstaton angazhimin institucional për financimin e aktivitetit kërkimor të njësisë bazë që ofron programin e studimit.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.9 Relacion per realizimin e buxhetit per vitin 2021 dhe planifikimi per vitin 2022, FEA.PDF; vizita ne institucion]</p>								
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e programit të studimit përcakton objektivat e programit të studimit në përputhje me objektivat kryesorë të institucionit. - UBT respekton lirinë akademike të personelit akademik. - UBT angazhohet për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor duke financuar plotësisht studimet e doktoraturës për stafin akademik efektiv, duke përfshirë studentët në konferenca dhe referime shkencore dhe mbështetjes financiare që ofron në këtë kontekst si edhe duke ofruar financimin e botimeve shkencore me faktor impakti. 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="539 1422 746 1523"></th> <th data-bbox="746 1422 938 1523">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="938 1422 1145 1523">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1145 1422 1380 1523">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="539 1523 746 1585"></td> <td data-bbox="746 1523 938 1585"></td> <td data-bbox="938 1523 1145 1585"></td> <td data-bbox="1145 1523 1380 1585" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në RVB, GVJ ndeshi fakte që tregojnë se Institucioni ka instrumentalizuar procedurat e menaxhimit të projekteve kërkimore dhe shkencore qysh në hapat e para të tyre. Në dokumentin “Rregullore mbi hartimin dhe menaxhimin e projekteve në UBT” paraqiten procedurat që duhet të ndiqen për çdo lloj projekti (me financim nga UBT, ose me financim nga jashtë) qysh në fazën e shpërndarjes së thirrjes për aplikim, në dorëzimin e aplikimit, shpalljes së fituesit, komunikimit të brendshëm, mbajtja e evidencës, dokumentimi i efekteve financiare të projektit, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të projektit, anëtarëve të tij dhe çdo strukture tjetër të përfshirë në UBT.</p> <p>Veç evidencës shkresore, gjatë vizitës në Institucion, GVJ mori konfirmim për nivelin e lartë të përfshirjes në projekte të stafit të DFK dhe të angazhuar në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” duke formuar bindjen se shkalla e lartë e bashkëpunimit institucional me struktura të tjera kërkimore, në kuadër të projekteve mundëson realizimin e objektivit të programit të studimit për formimin e specialistëve të aftë në fushat e kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.22. Rregullore mbi hartimin dhe menaxhimin e projekteve te UBT-se..pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton në Planin strategjik të kërkimit të UBT se kërkimi është një ndër misionet kryesore të këtij Institucioni. Parimet që Institucioni ndjek për kërkimin, sic shprehen në këtë plan strategjik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkimi efektiv duke u përballur me konkurrencën jashtë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. ▪ Optimizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në kushte konkurrence. ▪ Treg i hapur për studiuesit për të lehtësuar lëvizshmërinë. ▪ Qarkullimi i njohurive dhe përdorimi i tyre. <p>Hartimi dhe zbatimi i një strategjie të posaçme për kërkimin shkencor vlerësohet shumë pozitivisht nga GVJ. Angazhimi i personelit akademik në projekte dhe procedurat e shpërndarjes së thirrjeve të reja janë përshkruar me detaje në rregulloren e posaçme të hartuar për këtë qëllim.</p>

	<p>Gjithashtu nga tabelat e RVB dhe nga dokumentet “Lista e Projekteve” dhe “Lista e Konferencave” konstatohet se të paktën tre anëtarë të DFK janë koordinatorë të projekteve ndërkombëtare, kurse 20 pedagogë të angazhuar në këtë program studimi janë partnerë të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare (tabela 19 në RVB). Siç u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion me vlerë të shtuar për programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” është përfshirja e anëtarëve të DFK në një projekt të rëndësishëm ndërkombëtar me fokus Kontabilitetin Publik dhe standardet e kontabilitetit në këtë sektor.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.20. Lista e konferencave, revistave dhe website të UBT-së dhe FEA-s.pdf; Aneks I.22. Rregullore mbi hartimin dhe menaxhimin e projekteve të UBT-se..pdf; Aneks I.23. Plani Strategjik i Kerkimit, Universiteti Bujqesor i Tiranës 2016-2025, Qershor 2016.PDF; Aneks III.6 Lista e projekteve FK.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Institucioni raporton në RVB për këtë kriter një sërë aktiviteteve shkencore të organizuara dhe që janë në interes edhe të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”. GVJ ndeshi evidencë të një konference studentore të organizuar në vitin 2021 në bashkëpunim me një tjetër IAL në vend. Studentët e programit të studimit kishin pasur mundësi të angazhoheshin në këtë konferencë me tarifa zero. Gjithashtu edhe gjatë vizitës në Institucion stafi pedagogjik dhe studentët u shprehën për përfshirjen e tyre në aktivitete që në tërësi ndihmojnë në arritjen e objektivave të programit të studimit dhe këto aktivitete janë të listuara edhe në dokumentacionin shoqëruar në RVB.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.20. Lista e konferencave, revistave dhe website të UBT-së dhe FEA-s.pdf; Aneks III.6 Lista e projekteve FK.pdf; Aneks III.11 Konference studentore organizuar nga DFK-UNIV.LOGOS.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Formimi i profesionistëve të aftë për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit është ndër synimet dhe objektivat e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” (Rregullorja e programit, neni 3, pika c). GVJ vlerëson se arritja e këtij synimi mbështetet nga ofrimi i një game lëndësh të pasura me njohuri dhe kompetenca në profesionin e kontabilistit dhe</p>



	<p>audituesit, lëndë që përcohen tek studentët nga një staf akademik i kualifikuar dhe cilësor.</p> <p>Sipas të dhënave nga tabela 21 në RVB shihet se nga 80 studentë të diplomuar në vitin 2021-2022, 24 prej tyre janë të punësuar në profesion qysh në momentin e kryerjes së praktikës profesionale.</p> <p>Raporti i gjurmimit të studentëve të UBT, pavarësisht se nuk është i fokusuar specifikisht në studentët e këtij program studimi, jep evidencë për nivelin e kënaqshëm të punësimit të studentëve të këtij institucioni.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.19 Analiza e pyetesorit, AUT.pdf; Aneks I.24. Raport Gjurmimi i Studenteve te UBT-se..PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Sipas RVB për këtë pikë, fakti që stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi janë njëherazi edhe anëtarë të shoqatave të ndryshme profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, jep garanci për marrjen në konsideratë të kërkesave ligjore në këtë profesion.</p> <p>Përtej kësaj, GVJ në njohurinë që ka për organizimin e profesionit kontabël dhe auditues dhe kërkesat e shoqatave profesionale vendase dhe të huaja në këtë fushë, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit dhe lëndët e modulet e ofruara në të, reflektojnë kompetencat e nevojshme që një profesionist duhet të ketë për ndjekjen e kualifikimeve profesionale të parashikuara nga kuadri ligjor vendas për marrjen e licencës së profesioneve të lira në fushën e kontabilitetit (Kontabilist i Miratuar apo Auditues Ligjor). Lëndët e ofruara në program dhe temat në programet lëndore janë të nevojshme dhe të dobishme jo vetëm për punësim, por edhe për t’iu nënshtruar procesit të certifikimit profesional në fushën e auditimit dhe kontabilitetit brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.8 CV-të e stafit ndihmes akademik në DFK.pdf; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p>

	<p>- UBT është i angazhuar në projekte kërkimore e shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe në funksion të arritjes së objektivave dhe synimeve të programit të studimit.</p> <p>- Programi i studimit kompletion njohuritë e studentëve duke garantuar formim shkencor të tyre si edhe jep lehtësi për ndjekjen e kualifikimeve profesionale të mëtejshme në fushën e kontabilitetit dhe auditimit të parashikuara nga kuadri ligjor vendas për marrjen e liçencës së profesioneve të lira.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, edhe e dosjes së programeve lëndore, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, seminarat, detyrat e kursit/ esetë dhe praktikatat profesionale.</p> <p><i>Tabela 12 e RVB jep informacionin e detajuar sa më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Leksione 540 orë ▪ Seminare 540 orë

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Praktikë profesionale 500 orë ▪ Diploma/ Provim Formimi 250 orë <p style="text-align: center;">Totali 1'830 orë</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.4.1-3 Struktura mesimore dhe Kurikula 2019-2022.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit jepen format e parashikuara të mësimin të cilat duke qënë të larmishme garantojnë transmetimin dhe përfitimn e dijeve në mënyra të ndryshme. Edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta dhe fleksibël e nxitëse për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike.</p> <p>Po kështu edhe studentët u shprehën pozitivisht për procesin mësimor duke konfirmuar ekzistencën e formave dhe mënyrave të ndryshme alternative të mësimin, sidomos formave të reja të mundësuar edhe me ndihmën e teknologjisë si shfrytëzimi i sistemeve të informacionit në kontabilitet dhe aksesin në bibliotekat mësimore online.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter cilësohet kryesisht investimi institucional në aspektin logjistik për të lehtësuar procesin mësimor nga pikëpamja teknologjike. GVJ, gjatë vizitës në Institucion konfirmoi me stafin akademik se institucioni realizon trajnimet e nevojshme për të përmirësuar kompetencat didaktike të tyre. Kështu, stafi citoi se ka pasur vazhdimisht trajnime për mësimdhënie të cilat bëhen publike edhe në faqen e UBT. Trajnime të tjera janë ofruar në kuadrin e projekteve, me lektorë të huaj, nga Ministria e Financave, për përgatitjen për aplikimin në projekte të ndryshme, për pronësinë intelektuale, dhe për e-learning.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV të stafit akademik si edhe nga diskutimet me përfaqësues të stafit akademik të Institucionit gjatë vizitës,</p>

<p>mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ formoi bindjen se UBT ka punësuar staf të përgatitur që është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të rëndësishme për këtë program studimi. Gjithashtu, GVJ konstatoi përdorimin e metodave të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve në procesin mësimor duke kombinuar leksionet, me detyrat e shtëpisë dhe detyrat në klasë, rastet praktike dhe projektet e kursit. Edhe nga diskutimet me përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës, GVJ formoi bindjen se personeli akademik përdor realisht metoda të ndryshme interaktive për të garantuar angazhimin e studentëve në procesin mësimor. Stafi akademik u shpreh se studentët e këtij programi studimi janë kryesisht studentë cilësorë dhe të përkushtuar të cilët kanë rezultate mjaft të larta.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.3 CV-të e stafit akademik të angazhuar në DFK dhe MPKA.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, procesi i përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe i vlerësimit të pedagogëve kryhet rregullisht duke i mëshuar zbatimit serioz të disiplinës në procesin mësimor. Studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Senat dhe në Këshillat studentorë, por edhe nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të vlerësimit të procesit mësimor.</p> <p>GVJ konstatoi si pjesë të RVB edhe pyetësorët për vlerësimin e procesit mësimor dhe praktika e plotësimit të pyetësorëve u konfirmua edhe nga studentët e programit të studimit. Pyetësori me studentët fokusohet në vlerësimin e përmbajtjes së lëndës, materialeve si edhe cilësisë së mësimin me pedagogun titullar të lëndës / modulit. Në nivel Institucional është NJSBC që bën vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së këtyre metodave. Institucioni gjithashtu shihet se realizon dhe publikon analiza të aktivitetit mësimor duke nxitur praktikat më të mira.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarisë mesimore dhe kërkimore periudha 2020-2021.PDF; Aneks II.14 Format Pyetesori per Vleresimin e Procesit Mesimor.PDF; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në</p>	<p>Siç konfirmohet nga analiza e Rregullores së Drejtorisë së Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë (kreu 1, neni 3), kjo</p>




<p>nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>drejtori ndjek problemet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor në UBT, me të gjitha procedurat, aktivitetet dhe dokumentet për vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucional, kontrollin dhe harmonizimin e dokumenteve administrative që rregullojnë zhvillimin normal të procesit mësimor në nivel fakulteti me dokumentet e këtij lloji në nivel universiteti, si dhe vlerësimin e brendshëm në lidhje me akreditimin institucional dhe të programeve mësimore dhe sigurimit të cilësisë së tyre.</p> <p>RVB për këtë kriter vlerëson se stafi i angazhuar në këtë program studimi mbështetet vazhdimisht nga strukturat dhe njësitë përgjegjëse për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Vetë stafi e konfirmon mbështetjen institucionale në drejtim të rritjes së cilësisë së aftësive didaktike dhe mësimdhënëse sidomos në kushtet e mësimi online.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.7. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise (DVBSC), Korrik 2021.pdf; vizita ne institucion]</p>
--	---

<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT bën përpjekjet e nevojshme procedurale për të garantuar procesin e mësimi cilësor dhe në funksion të arritjes së synimeve të programit. - Procesi mësimor është i fokusuar tek studenti për të lehtësuar mësimnxënien dhe karakterizohet nga praktikat më të mira. - UBT angazhohet në drejtim të përmirësimit të kompetencave didaktike të stafit duke i trajnuar në aspekte të ndryshme. - Organizimi i procesit mësimor është cilësor dhe garanton marrjen dhe praktikimin e njohurive në fushat e kontabilitetit dhe auditimit.
---------------------------	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi III.2


44

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive e dijeve të studentëve përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT. Vlerësimi përfshin, vlerësimin gjatë semestrit, detyrat dhe projektet e kursit si edhe vlerësimin gjatë testeve të lëndës. Provimet janë me shkrim kurse detyrat dhe projektet e kursit prezantohen para grupit mësimor.</p> <p>Mënyra e vlerësimit të njohurive të studentëve gjithashtu ishte përfshirë si pjesë e programeve lëndore. Shkalla e njohjes së studentëve me mënyrën e vlerësimit është gjithashtu e lartë pasi kjo ishte e përfshirë në programet lëndore, të cilat u viheshin studentëve në dispozicion qysh në fillim të çdo semestri dhe zakonisht prezantoheshin në orën e parë të programit të lëndës.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lënde/moduli me elementet e lëndës, ndër të tjera edhe me metodologjinë e vlerësimit. Zakonisht ora e parë e çdo lënde rezervohet për prezantimin e detajuar nga ana e titullarit të lëndës të përmbajtjes së lëndës / modulit dhe detyrimeve të studentëve. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet kanaleve të brendshme të komunikimit student / pedagog në klasat e menaxhuara në platformën e menaxhimit të mësimin dhe nëpërmjet emailit institucional me të cilin ishte i pajisur çdo student.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi programet lëndore të disiplinave të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, vërejti se në to ka elemente të larmishme të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve si: provimet dhe testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit</p>

<p>ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>dhe niveli i aktivizimit në seminare. Një përmbledhje e peshës që ka çdo formë vlerësimi jepet edhe në <i>tabelën 14</i> në RVB dhe GVJ konstaton se kjo formë organizimi ndiqet me përjashtime shumë të vogla) në çdo lëndë të programit.</p> <table data-bbox="635 383 1257 600"> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Testimet gjatë vitit</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>60%</td> </tr> </table> <p>GVJ gjykon se përfshirja e një larmie të formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara në njërën ose disa prej formave të zgjedhura të kontrollit të dijeve, të cilat janë jo vetëm të ndryshme (duke dhënë mundësi shprehjeje çdo tipologjie dhe personaliteti të studentëve), por për më tepër janë edhe të shpërndara përgjatë semestrit duke ndjekur në mënyrë të vazhduar ecurinë e studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim, Qershor 2021.PDF; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita ne institucion]</i></p>				Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%	Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)	10%	Testimet gjatë vitit	20%	Provimi përfundimtar	60%
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%											
Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)	10%											
Testimet gjatë vitit	20%											
Provimi përfundimtar	60%											
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator i UBT përfshin forma të ndryshme kontrolli dhe vlerësimi të cilat u bëhen me dije studentëve para fillimit të lëndës.</i> - <i>Këto forma të ndryshme kontrolli garantojnë një shpërndarje dhe mbulim të mirë të vlerësimit të çdo studenti në këtë program studimi.</i> 											
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>								

<p>Standardi III.3</p> <p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në dosjen e syllabuseve, GVJ vërejtë elemente dhe forma të larmishme të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve të këtij programi studimi. Këto mënyra të testimit të njohurive jo vetëm që janë të ponderuara në mënyra të ndryshme rëndësie si më poshtë por edhe shpërndahen përgjatë gjithë semestrit duke ofruar mundësinë e nxitjes së vazhdueshme të studentëve në kohë.</p> <table data-bbox="622 492 1244 739"> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Testimet gjatë vitit</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>60%</td> </tr> </table> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në Institucion dhe kontakti me studentët e programit se kjo formë vlerësimi ishte e mirëpritur nga ata dhe i mbante të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për procesin mësimor i ndihmuar drejt arritjes së rezultateve të mira dhe përfitimit të njohurive të plota.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita ne institucion]</i></p>	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%	Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)	10%	Testimet gjatë vitit	20%	Provimi përfundimtar	60%
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%								
Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj)	10%								
Testimet gjatë vitit	20%								
Provimi përfundimtar	60%								
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstatoi në RVB evidencë për aplikimin e metodës elektronike dhe anonime të vlerësimit Clean score. Kjo metodë jo vetëm garanton anonimatit e studentit por është edhe mjaft efektive përse i përket vlerësimit të studentit, duke qenë se rrit transparencën e procesit dhe aspektin kohor të korrigjimit dhe vlerësimit të provimit. Sipas RVB, Platforma CleanScore ofron edhe korrigjimin e provimeve online në sistemin LMS të UBT, metodë e cila u përdor me efektivitet gjatë periudhës së pandemisë. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati konfirmim nga stafi akademik i angazhuar në programin e studimit se metodat elektronike të vlerësimit ishin përdorur me sukses për vlerësimin e studentëve.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.10 Clean Score projekti AADF.pdf; vizita ne institucion]</i></p>								
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, dhe konfirmuar edhe gjatë vizitës në Institucion, vlerësimet e lëndës hidhen në sistemin elektronik Pitagora, ku ruhen dhe akumulohen derisa shtohet edhe vlerësimi i provimit përfundimtar. Vlerësimet e dhëna gjatë vitit ruhen në sistemin Pitagora edhe për provime në sezona të tjera të ardhshme në rastet kur studenti rezulton jo kalues në</p>								




	<p>sezonin aktual. Vlerësimi me notë bëhet mbështetur në totalin e vlerësimeve gjatë vitit dhe provimit përfundimtar (Rregullorja e programit të studimit) dhe është sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me nota kaluese nga 5 deri në 10.</p> <p>Në <i>nenin 29</i> të Rregullores së programit jepet një paraqitje e detajuar e tabelës së konvertimit të pikëve totale në nota. Kjo mënyrë vlerësimi përfshihet gjithashtu edhe në syllabuset e çdo lënde për të rritur transparencën e komunikimit me studentët dhe të tjerë të interesuar.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.25 Manual i perdorimit te platformes Pitagora.PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (<i>neni 38 pika 2</i>) GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar se pas shpalljes së rezultateve paraprake, student ka të drejtë të ketë komente dhe feedback për mënyrën e vlerësimit. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur.</p> <p>Bazuar në këtë parashikim të rregullores, por edhe në konfirmimin e marrë gjatë përshkrimit të procedurës së vlerësimit me studentët dhe stafin, GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (<i>neni 36, pika 4</i>) GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar se nëse studenti përdor në provim forma apo mjete të palejueshme ai do të përjashtohet nga provimi. Edhe në vizitën në Institucion, stafi u shpreh se asnjë formë e plagjiarizimit nuk tolerohet dhe studentëve u sqarohet me shumë detaje se çfarë përbën plagjiarizëm duke synuar formimin dhe edukimin e tyre për të ushtruar aktivitetet kërkimor dhe mësimor cilësor.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; vizita ne institucion]</i></p>

<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (<i>neni 38 pika 1</i>) GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar se pas provimit ka një afat maksimal deri në 8 ditë që rezultatet prapake të provimit të hidhen në sistem nga ana e komisionit të provimit. Sistemi ku hidhen vlerësimet është sistemi Pitagora ku kanë akses të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe të gjithë studentët e këtij programi studimi. Nëse ka kërkesa për rishikim të rezultatit të provimit studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi brenda 48 orëve nga koha e afishimit në sistem të rezultateve prapake.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.25 Manual i përdorimit të platformes Pitagora.PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (<i>neni 38 pika 2</i>) GVJ konstatoi se nga ana procedurale ishte parashikuar se pas shpalljes së rezultateve prapake, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi, pra të ketë komente dhe feedback për mënyrën e vlerësimit. Afati për këtë hap të procesit është 48 orë. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas ballafaqimit nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem brenda dy ditëve.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit (<i>neni 39</i>) GVJ konstatoi se studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin nëse ndaj tij janë shkelur rregullat e zhvillimit të provimit apo nuk është dakord me rezultatin e rishikuar nga komisioni i provimit. Në këto raste ai bën një ankesë me shkrim brenda dy ditëve duke iu drejtuar Dekanit të Fakultetit.</p> <p>Dekani pasi shqyrton ankesën mund të thërrasë për sqarime përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit si edhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë ose jo dhe merr vendimin e tij i cili është i formës së prerë. Pra, GVJ konstaton se sipas rregullores në këtë hap nuk</p>




	<p>ngrihet një komision i posacëm por është dekani i cili menaxhon procedurën. Të gjitha këto ankime të studentëve regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve i cili ruhet në dekanat.</p> <p>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; vizita ne institucion]</p>								
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e programit të studimit parashikon të gjitha procedurat që lidhen me vlerësimin e studentëve, procedurën e ankimit dhe rishikimit të vlerësimit, si edhe vlerësimin përfundimtar të studentëve. - Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. - Procedura e parashikuar dhe e ndjekur për vlerësimin, kombinohet edhe me metoda elektronike të vlerësimit (Clean Score) duke garantuar një rezultat të drejtë dhe të paanshëm për vlerësimin e studentit. 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të RVB si edhe përshtypjeve dhe perceptimeve të studentëve dhe stafit, si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ formoi opinionin se programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT zhvillohet në mënyrë të tillë që u mundëson studentëve të thellojnë njohuritë e tyre dhe të zhvillojnë aftësi profesionale në këtë fushë me synim përgatitjen e profesionistëve të kontabilitetit dhe të auditimit. Këta profesionistë janë të kërkuar në tregun e punës në Shqipëri, dhe pritshmëria është që të vazhdojë të ketë kërkesë për profesionistë



	<p>të kësaj fushe edhe në të ardhmen. GVJ vlerëson se njohuritë e përcjella nëpërmjet moduleve dhe çështjeve të përfshira në programet lëndore të programit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT garantojnë thellimin në njohuri specifike të fushës.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nga shqyrtimi i Plani Mësimor (tabela 10 në RVB) dhe i programeve lëndore të “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, GVJ konstatoi se ka disa lëndë dhe tema të cilat trajtojnë elemente të sistemeve të kompjuterizuara kontabël, në përshtatje kjo me zhvillimet e këtij profesioni vitet e fundit. Gjithashtu, lëndë si Etika në Biznes, që është lëndë e detyrueshme bazë e programit të studimit, i pajisin studentët me aftësinë për të dalluar situata kritike që kërkojnë ushtrimin e gjyqimit profesional për të marrë vendime jo vetëm teknikisht të sakta, por edhe të pakontestueshme profesionalisht. Kjo lëndë është e rëndësishme për dimensionin human e social të profesionit të kontabilistit dhe audituesit në përputhje kjo edhe me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit në profesionin përkatës.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se të gjitha programet lëndore të Programit të Studimit, “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, kanë të përfshira si një seksion të veçantë në fillim të tyre “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, kjo në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr.41 të ndryshuar. Ky element liston përfitimet e pritshme nga çdo lëndë e programit për të mbërritur në përmbushjen e objektivave të programit të studimit dhe sipas tabelës 13 në RVB fokusohet në synimet, njohuritë dhe aftësitë e kompetencat që pritet të ketë studenti në përfundim të studimeve të asaj lënde specifike.</p> <p>Gjithashtu, sipas diskutimeve të kryera me studentët dhe stafin e programit të studimit, gjatë vizitës në Institucion u konstatua se në përfundim të lëndës gjithmonë rezervohet një seancë përmbledhëse e njohurive të marra, çka i ndihmon studentët të jenë më të përgatitur në kuadër të provimit përfundimtar.</p>



	<i>[Referenca: Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita ne institucion]</i>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”, GVJ formoi përshtypjen se ata ishin të fokusuar në realizimin e procesit mësimor në bazë të kompetencave duke qenë të hapur dhe mbështetës për dinamikën e punës në grup sidomos në këtë program specifik në nivelin e dytë të studimeve që ka edhe fokus praktik. Vëmendje e theksuar i jepet zhvillimit të praktikës profesionale e cila zhvillohet në shumë institucione me të cilat UBT bashkëpunon. Duke qenë program i ciklit të dytë profesional, fokusi është më tepër në zhvillimin e aftësive profesionale sesa ato studimore dhe shkencore të përparura. Megjithatë, pavarësisht fokusit profesional, programi i studimit ka pasur në historikun e tij edhe ngjarje me karakter kërkimor dhe shkencor, ku GVJ veçon organizimin e konferencave studentore të përbashkëta me IAL të tjera ku studentët marrin pjesë pa paguar tarifa pjesëmarrjeje.</p> <p><i>[[Referenca: Aneks III.9 Syllabuset.pdf; Aneks III.11 Konference studentore organizuar nga DFK-UNIV.LOGOS.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, përmendet cilësia e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT si një faktor që garanton realizimin e seminareve mbi zhvillime të reja të shkencës brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit. GVJ konfirmon cilësinë e këtij stafi dhe faktin që ata janë ekspertë të fushave përkatëse dhe anëtarë të shoqatave të rëndësishme në vend në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit, por nuk ndesh evidencë në RVB për organizimin e orëve të hapura. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, përfaqësues të stafit akademik konfirmuan organizimin e leksioneve të hapura me lektorë vendas dhe të huaj në kuadrin e projekteve të institucionit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative,</p>	<p>Nga RVB dhe tabelat shoqëruese, GVJ konstaton se studentët e programit të studimit janë nxitur vazhdimisht të përfshihen në</p>

<p>studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>aktivitete kërkimore dhe shkencore duke i angazhuar ata në detyra kursi, projekte diplome si edhe artikuj të përgatitur bashkarisht me pedagogët e tyre udhëheqës. Këta artikuj janë paraqitur në konferenca studentore, por edhe janë botuar në revistën shkencore të njësisë kryesore, FEA (Journal of Economy and Agrobusiness, JEA), pa pagesë.</p> <p>Përveç botimit në revistën shkencore të vetë Institucionit, më lart në këtë raport GVJ ka konstatuar angazhimin e studentëve të programit të studimit në konferenca shkencore studentore së bashku me IAL të tjera vendase. Duke konsideruar këto fakte, GVJ është e mendimit se Institucioni plotëson këtë kriter dhe angazhohet në mënyrë të evidentuar në avancimin e ideve inovatore të studentëve.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.3.1-3 FEA, Analiza e veprimtarisë mesimore dhe kërkimore, periudha 2019-2022.PDF; Aneks IV. Tabelat përmbledhese të RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT angazhohet në avancimin e ideve inovatore të studentëve duke i mbështetur ata të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre mësimor, profesional dhe kërkimor. - Planet mësimore dhe programet lëndore janë të pasura me çështje të rëndësishme për zhvillimin e studentëve. - Mësimdhënia realizohet në mënyrë profesionale nga një staf akademik i kualifikuar dhe profesionistë të njohur në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për

Referuar dokumentacionit në RVB, GVJ konstaton se janë parashikuar dhe paraqitur në mënyrë të detajuar procedurat që

<p>detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”: provimin e përgjithshëm final ose përgatitjen e punimit së diplomës. Sipas Rregullores së programit të studimit, DFK organizon dy sezona diplomimi për çdo vit akademik (shtator dhe mars të çdo viti), datat e të cilëve përcaktohen nga drejtuesi i njësisë kryesore FEA. Studenti ka të drejtë të hyjë në sezonin më të afërt të diplomimit pasi ka shlyer detyrimet e kurrikulës. Nota mesatare e studentëve që mund të përgatisin punim diplome është 6.5 e lart. Studenti që plotëson kriterin e notës mesatare ka të drejtë të paraqesë kërkesën në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e saj.</p> <p>Përvec sa është parashikuar në rregulloren e programit të studimit, institucioni ka përgatitur edhe një paketë orientuese për studentët në lidhje me diplomimin. Kjo paketë përmban temat e sugjeruara orientuese për punimin e diplomës apo orientime për përgatitjen e provimit final në varësi të mënyrës së diplomimit. Në takimin e zhvilluar me studentët e programit të studimit, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se informacioni në lidhje me shlyerjen e detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit, u vihet në dispozicion studentëve përpara fillimit të përgatitjes së tyre për diplomim.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks III.13 Paketa orientuese e diplomimit.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të studimit (<i>neni 14, pika 8</i>) dhe konfirmuar edhe gjatë vizitës në Institutin, udhëheqësi i punimit të diplomës asiston studentët në procesin e diplomimit duke përcaktuar grafikun e konsultimeve përgjatë të cilave kontrollohet ecuria e përgatitjes së punimit dhe gjithashtu i udhëzon studentët për fushën e përgatitjes së punimit, strukturën, metodologjinë, etj.</p> <p>Studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm orientohen në lidhje me tematikat nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit (rregullorja e programit të studimit, <i>neni 14, pika 10</i>). Programi për provimin final hartohet nga stafi i njësisë bazë, DFK, miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i</p>




	<p>fakultetit dhe u bëhet e ditur studentëve e shpallet në faqen e internetit të institucionit.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks III.13 Paketa orientuese e diplomimit.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, (neni 14, pika 10), studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm orientohen në lidhje me tematikat nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Provimi realizohet si një detyrim me gojë (neni 14, pika 13), para një komisioni të posaçëm të përbërë nga pedagogë të departamentit nga fushat që mbulon programi i provimit. Teza e provimit përmban pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit dhe përgatitet nga anëtarët e komisionit të provimit mbështetur në fondin e pyetjeve që krijohet në përputhje me peshën specifike dhe rëndësinë e çdo fushe (neni 14, pika 12).</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks III.13 Paketa orientuese e diplomimit.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, (neni 14, pika 8&9), udhëheqësi i punimit të diplomës asiston studentët në procesin e diplomimit duke përcaktuar grafikun e konsultimeve përgjatë të cilave kontrollohet ecuria e përgatitjes së punimit dhe i udhëzon ata për elemente të nevojshme të këtij procesi. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke e firmosur atë. Kjo procedurë e parashikuar në rregulloren e programit të studimit dhe në paketën orientuese u konfirmua edhe nga stafi dhe studentët gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks III.13 Paketa orientuese e diplomimit.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në</p>	<p>Referuar diskutimeve të kryera me stafin dhe studentët e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT, gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi</p>

<p>mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>mbështetjen institucionale të studentëve për kryerjen e analizave dhe hulumtimeve të nevojshme për realizimin e punimit të diplomës. Në dispozicion të studentëve ishin vendosur dy laboratorë kompjuterikë si edhe biblioteka e UBT. Mbështetur në të dhënat e RVB, UBT ka vendosur në dispozicion të studentëve të programit të studimit biblioteka online si JSTOR, Edward Elgar, IOPSCIENCE dhe ASTM, të cilat janë në ndihmë të studentëve për kryerjen e analizave në funksion të fushave të tyre të studimit. Bazuar në sa më lart GVJ konfirmon realizimin e këtij kriteri në përputhje me çfarë është parashikuar në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; Aneks III.13 Paketa orientuese e diplomimit.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në UBT, studentët vlerësohen me nota sipas sistemit shqiptar, kunotat kaluese janë nga 5 deri në 10. Intervallet e pikëve për notat kaluese janë parashikuar në rregulloren e programit të studimit, <i>neni 29</i>.</p> <p>Gjithshtu, sipas rregullores së programit të studimit, (<i>neni 14, pika 13</i>), rezultatet e provimit të formimit dhe të temës së diplomës u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi. Komisioni i provimit merr në shqyrtim çdo ankesë të studentëve përpara se të marrë vendimin përfundimtar. Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, atëherë bëhet ndryshimi i vlerësimit. Në përfundim, komisioni hedh notën në sistem, printon procesverbalin i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit si edhe më pas nga personat e tjerë përgjegjës.</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve,</p>	<p>Për analizën e shkallës së përmbushjes së këtij kriteri, GVJ shqyrtoi Rregulloren e Institucionit, atë të njësisë kryesore që ofron programin e studimit FEA, si edhe Rregulloren e programit të studimit. GVJ konstatoi se në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomë “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”, modeli i së cilës miratohet nga Senati Akademik. Diploma firmoset nga Dekani i FEA dhe</p>



<p>studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Rektori i UBT. Diploma shoqërohet gjithmonë me listën e notave dhe suplementin e diplomës sipas modelit të miratuar. Këto elemente të parashikuara në rregulloret përkatëse u konfirmuan nga GVJ gjatë vizitës në Institucion se zbatoheshin në mënyrë rigoroze, duke mbështetur plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA).PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim.PDF; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë që të verifikonte ruajtjen e dokumentacionit të studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT. GVJ shqyrtoi informacione për studentët pranë sekretarisë mësimore që është struktura e ngarkuar me këtë detyrë. Ndër këto informacione, u kërkuan të dhëna në lidhje me procesverbalet e lëndëve, regjistrat e studentëve dhe të dhëna të tjera në lidhje me studentët e diplomuar dhe u konstatua përmbushja e kërkesave për informacion të paraqitur nga ana e tyre. Sipas konfirmimit të GVJ, sekretaria mësimore mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme, formularët e regjistrimit, evidenca për notat dhe vlerësimet, etj në regjistra në formate të përcaktuara sipas akteve ligjore në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator UBT parashikon në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit. “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim.</i> - <i>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në procesin e përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse.</i> - <i>Në përfundim të ciklit të studimeve, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e saj.</i> - <i>Pranë UBT dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>




Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Sipas RVB, Departamenti i Financë Kontabilitetit në UBT që është njësia përgjegjëse që e ofron këtë program studimi, përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse duke vendosur në dispozicion të studentëve listën e Institucioneve me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi. Kjo listë përmbledhet me numra edhe në tabelën 5.1 të RVB ku konstatohen 62 marrëveshje në total. UBT ka raportuar edhe ambiente të brendshme në dispozicion të kryerjes së praktikave laboratorike (laboratorë) dhe praktikës profesionale. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi mbështetjen e Institucionit për studentët e programit në drejtimin e realizimit me sukses të praktikave profesionale.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.14 Paketa e praktikës profesionale.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi pasi nuk parashikohet kryerja e praktikave klinike apo stazheve.</p>
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në</p>	<p><i>Në këtë kriter, GVJ po vlerëson vetëm për praktikrat profesionale dhe jo për praktikrat klinike apo stazhet të cilat nuk kanë lidhje me programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” në UBT.</i></p> <p>Specifikat e kryerjes së praktikave profesionale për programet e Masterit Profesional janë shprehur në Rregulloren e FEA, neni</p>



<p>dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>45. Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Departamenti mban përgjegjësi për evidentimin e partnerëve të praktikës (institucione dhe kompani) sipas profilit dhe për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me to. Studentët duhet të kryejnë 100% të orëve të praktikës profesionale dhe duhet të respektojnë rregullat e institucionit pritës. Në përputhje me Planin Mësimor, praktika profesionale konvertohet në 20 ECTS. Gjatë procesit të praktikës studentët drejtohen nga stafi akademik i caktuar nga departamenti përkatës (rregullorja e programit, <i>neni 13, pika 6</i>) dhe kjo u konfirmua edhe nga drejtuesi i departamentit gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet në datën e caktuar nga Departamenti dhe komisioni që ai ngre dhe mbart edhe vlerësimin nga drejtuesi në vendin e praktikës. Vlerësimi i praktikës profesionale në procesverbal bëhet “Fiton/Nuk fiton”.</p> <p>Kjo procedurë e parashikuar për organizimin dhe supervizimin e studentit gjatë procesit të praktikës, u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion dhe ky kriter konsiderohet i përmbushur.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit.PDF; Aneks III.14 Paketa e praktikës profesionale.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita ne institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Financë-Konatabilitetit gjen partnerët e realizimit të praktikës profesionale sipas profilit dhe lidh marrëveshje bashkëpunimi me to. - Në përputhje me Planin Mësimor, praktika profesionale konvertohet në 20 ECTS. - Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet në datën e caktuar nga Departamenti dhe komisioni që ai ngre dhe mbart edhe vlerësimin nga drejtuesi në vendin e praktikës. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		




				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se personeli akademik dhe ndihmës që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore.</p> <p>Numri dhe kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitet 2020-2023 paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>për vitin akademik 2020-2021</u> janë angazhuar gjithsej 21 pedagogë, nga të cilët 16 pedagogë si personel akademik me kohë të plotë (PAE) me kualifikimet: <ul style="list-style-type: none"> 5 Profesor 6 Profesor i Asociuar 5 Doktor i Shkencave <p>Personel akademik me kontratë (PAK) janë 5 pedagogë, dy prej të cilëve mbajnë titullin Profesor dhe tre të tjerët mbajnë gradën Doktor i Shkencave. Raporti është 76% PAE dhe 24% PAK.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>për vitin akademik 2021-2022</u> janë angazhuar gjithsej 20 pedagogë, nga të cilët 15 pedagogë si personel akademik PAE me kualifikimet: <ul style="list-style-type: none"> 4 Profesor 7 Profesor i Asociuar 4 Doktor i Shkencave <p>Personel akademik me kontratë janë 5 pedagogë, tre prej të cilëve mbajnë titullin Profesor dhe dy pedagogë mbajnë gradën Doktor i Shkencave. Raporti është 75% PAE dhe 25% PAK.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>për vitin akademik 2022-2023</u> janë angazhuar gjithsej 19 pedagogë, nga të cilët 14 pedagogë si personel akademik PAE me kualifikimet: <ul style="list-style-type: none"> 2 Profesor 8 Profesor i Asociuar 4 Doktor i Shkencave <p>Personel akademik me kontratë janë 5 pedagogë, tre prej të cilëve mbajnë titullin Profesor dhe dy pedagogë mbajnë gradën Doktor i Shkencave. Raporti është 74% PAE dhe 26% PAK.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij. Pranë Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit (DFK), përgjegjës për këtë program studimi, është e angazhuar edhe një punonjëse në rolin ndihmës akademik që kontribuon në procesin mësimor dhe kërkimor të departamentit nëpërmjet kryerjes së detyrave të ndryshme administrative.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.3 CV-të e stafit akademik të angazhuar në DFK dhe MPKA.pdf; Aneks III.8 CV-të e stafit ndihmes akademik në DFK.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e</p>	<p>GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p>



<p>studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për vitet akademike 2020-2023, ngarkesa mësimore në këtë program studimi është mbuluar mesatarisht në masë 75% nga pedagogë PAE dhe 25% nga pedagogë PAK. Gjithashtu, mesatarisht 67% e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi mbajnë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar dhe 33% mbajnë gradën Doktor i Shkencave.</p> <p>GVJ konstaton një ngarkesë totale të personelit akademik mbi normën e parashikuar sipas nivelit të kualifikimit, por brenda parashikimeve të mbingarkesës së lejuar sipas kuadrit rregullator në fuqi që merr parasysh numrin maksimal të lëndëve që mund të mbulojë një pedagog dhe orët suplementare për efekt pagese (praktikë tashmë karakteristike e IAL-ve publike).</p> <p><i>[Referenca: Aneks III.3 CV-të e stafit akademik të angazhuar në DFK dhe MPKA.pdf; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” dhe Departamentit të Financë-Kontabilitetit, si dhe punësimin e tyre pranë UBT në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Gjatë tre viteve të fundit akademike ndryshimet në personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi janë më pak se 9%.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.3 CV-të e stafit akademik të angazhuar në DFK dhe MPKA.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator të UBT, GVJ konstatoi se kriteret e përgjithshme të rekrutimit përcaktohen nga Senati i UBT, ndërsa kriteret specifike të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori i UBT.</p> <p>Rregullorja për Rekrutimin e Stafit përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit <i>ad hoc</i> që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Në rastin e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, Drejtuesi i Njesisë Bazë që mbulon programin e studimit për të</p>



<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>cilin synohet rekrutimi, është pjesë e komisionit <i>ad hoc</i> të vlerësimit. Në çdo rast, i gjithë procesi i rekrutimit ndiqet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Juridike dhe informacioni përkatës publikohet në faqen zyrtare web të UBT dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), miratuar 28.07.2021.pdf; Aneks I.4. Rregullorja e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, Dhjetor 2018.pdf; Aneks I.5. Rregullore për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ, UBT, Dhjetor 2018.pdf; Aneks I.26. Procedurat e Rekrutimit.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson përpjekjet e UBT për të angazhuar personel ndihmës akademik të përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të tjera, pjesë të programit mësimor, në përputhje me burimet në dispozicion. Aktualisht pranë FEA janë të punësuar 8 persona si personel akademik ndihmës, të angazhuar në aktivitete administrative dhe mirëmbajtje të laboratorëve dhe ambienteve mësimore, nga të cilët një person është i dedikuar për Departamentin e Financës & Kontabilitetit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks IV. Tabelat përmbledhese të RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të përditësuara për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”. Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Juridike, strukturë në varësi të Zv.Rektorit për Mësimin, është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave për personelin në formatin e dosjeve personale. Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.4. Rregullorja e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, Dhjetor 2018.pdf; https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt; vizita në institucion]</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në nivel njësie kryesore janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje private, institucione dhe organizata për realizimin e praktikës profesionale të studentëve të parashikuar në programin e studimit.</p> <p>Departamenti përmes sekretarisë dhe në bashkëpunim me Sektorin e Karrierës dhe Alumnit si dhe të platformës së projektit GRADUA u mundëson studentëve gjetjen dhe mbikëqyrjen e duhur të praktikës profesionale. Gjithashtu, departamenti lehtëson edhe bashkëpunimin e studentëve me institucionet për realizimin e punimit të diplomës, e parashikuar për studentët me mesatare mbi 6.5.</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Paketa e praktikës profesionale, me elementët e saj si kontrata, skeda etj, u mundëson edhe personelit mbikëqyrës në ambientin pritës të praktikës që të ndihmojnë studentët në realizimin e sukseshëm të saj dhe të marrin pjesë në procesin e vlerësimit të studentit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.15 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit QKA (praktika profesionale).pdf; Aneks II.2 Kërkesa dhe Kontrata për Praktike Profesionale në MP, KA.PDF; Aneks III.14 Paketa e praktikës profesionale.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënie në programe studimi Master. - Personeli akademik efektiv i DFK dhe ai i angazhuar në këtë program studimi është i qëndrueshëm. - Pranë FEA angazhohet personel ndihmës i përshtatshëm për realizimin e aktiviteve ndihmëse të procesit akademik. - Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Juridike mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë. - FEA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale dhe ka përgatitur udhëzues për

	<i>realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale dhe të temës së diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																		
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi. Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” e zhvillon procesin mësimor pranë mjediseve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), godinat A dhe B.</p> <p>Përmbledhtas të dhënat për mjediset në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë FEA paraqiten si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjedisi - FEA</th> <th>Nr. Sallash</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td>Salla seminari</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Zyra për stafin</td> <td>60</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Ambiente ndihmëse:</td> <td></td> </tr> <tr> <td>▪ Librari/fotokopje</td> <td></td> </tr> <tr> <td>▪ Zyre informacioni</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table>	Mjedisi - FEA	Nr. Sallash	Salla leksioni	14	Salla seminari	26	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	10	Zyra për stafin	60	Bibliotekë	1	Ambiente ndihmëse:		▪ Librari/fotokopje		▪ Zyre informacioni	6
Mjedisi - FEA	Nr. Sallash																		
Salla leksioni	14																		
Salla seminari	26																		
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	10																		
Zyra për stafin	60																		
Bibliotekë	1																		
Ambiente ndihmëse:																			
▪ Librari/fotokopje																			
▪ Zyre informacioni	6																		

	<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-bottom: 10px;"> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedise sherbimi </div> <p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të fundit të javës, nga e premtja në të dielë, sipas orarit mësimor të publikuar në fillim të çdo semestri.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.5 Infrastruktura FEA,2022.PDF; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset mësimore në të dy godinat A & B të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, janë të pajisura me pajisje të teknologjisë së informacionit që garantojnë lidhjen me internet sipas nevojave të përdoruesve.</p> <p>Sallat e leksionit dhe laboratorët janë të pajisura me videoprojektorë, tabela bashkëkohore, kompjutera dhe vende pune me internet.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon orë të detyrueshme laboratorike.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.5 Infrastruktura FEA,2022.PDF; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se megjithëse programi i studimit nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar, studentët pranë</p>




<p>teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>FEA kanë në dispozicion 9 laboratorë që mund t'i përdorin për realizimin e detyrave të kursit, përgatitjen e temës së diplomës, apo për aftësimin e pavaruar individual në module aplikative dhe të kontabilitetit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.5 Infrastruktura FEA,2022.PDF; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB si dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me kërkesat e parashikuara në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”.</p> <p>Aktualisht, për të mundësuar kryerjen e praktikës profesionale për studentët, FEA dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit i UBT, kanë ndërmjetësuar rreth 62 marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje private, institucione publike dhe organizata jo-fitimprurëse.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.15 Lista e marrëveshjeve te bashkepunimit QKA (praktika profesionale).pdf; Aneks III.14 Paketa e praktikës profesionale.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. - Klasat e leksioneve dhe të seminareve dhe ambientet e tjera janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një proces mësimor bashkëkohor. - Në dispozicion të studentëve janë 4 laboratorë informatike dhe ambiente të tjera në përdorim të përbashkët të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme në shërbim të tyre.



	- <i>Praktika profesionale zhvillohet në mjedise të përshtatshme sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura në nivel institucioni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar të RVB, GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse e rekomanduar në syllabuset e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” është në përputhje me nevojat për dije dhe njohuri të parashikuara për studentët e ciklit master. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Krahas literaturës në gjuhën shqipe, në syllabus studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në takimin me personelin akademik, GVJ mori konfirmimin se në fillim të çdo viti akademik, pedagogët bëjnë rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve dhe secili departament paraqet propozimin për listën e librave të nevojshëm për procesin mësimor dhe që duhet t’i shtohen fondit të bibliotekës. [Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.9 Syllabuset.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT vë në dispozicion të gjithë studentëve dhe stafit të tij, bibliotekën e universitetit “Mentor Përmeti” dhe bibliotekën e FEA. Bibliotekat janë të organizuara me disa ambiente dhe funksionojnë kundrejt anëtarësimit me kartelë regjistrimi.




<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Salla e bibliotekës së FEA është e organizuar me rreth 100 vende për studim, lidhje interneti wi-fi dhe 10 vende pune të pajisura me kompjutera për shfrytëzimin e burimeve online. Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të FEA si: tekste mësimore bazë dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë dhe botime të institucioneve të tjera. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëjloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.27. Informacion nga Bibloteka shkencore Mentor Permeti.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT, falë projekteve të ndryshme të bashkëpunimit, u mundëson akses të barabartë dhe të lirë në disa biblioteka dhe platforma online si LNSS, JSTOR, Edward Elgar, etj.</p> <p>Përmes adresave elektronike përkatëse, studentët mund të kërkojnë për artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së tyre të interesit. Sallat e studimit të bibliotekave janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme (kompjutera, videoprojektorë, lidhje wi-fi) të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët dhe pedagogët në aktivitetet mësimore dhe kërkimore.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.27. Informacion nga Bibloteka shkencore Mentor Permeti.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Përmes adresave elektronike përkatëse, studentët mund të kërkojnë për artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së tyre të interesit. Sallat e studimit të bibliotekave janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme (kompjutera, videoprojektorë, lidhje wi-fi) të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët dhe pedagogët në aktivitetet mësimore dhe kërkimore.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.27. Informacion nga Bibloteka shkencore Mentor Permeti.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstatoi se orari i shërbimit fizik të bibliotekës është 8.30-16.00 nga e hëna në të premte. Për t'u ardhur në ndihmë nevojave të studentëve është krijuar katalogu bibliografik online, si dhe një hapësirë e dedikuar në faqen zyrtare web të UBT që përditësohet me informacione mbi bibliotekën dhe aktivitetin e saj.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.27. Informacion nga Bibloteka shkencore Mentor Permeti.PDF; https://www.ubt.edu.al/biblioteka-e-universitetit; vizita në institucion]</i></p>




<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësité përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT është i angazhuar në shtimin dhe përditësimin periodik të fondit të bibliotekës sipas kërkesave të departamenteve, si dhe i ka përfshirë këto objektiva në prioritetet e zhvillimit strategjik afatgjatë.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqësor të Tiranës, 2016-2025.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</i> - <i>Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të UBT.</i> - <i>Institucioni angazhohet në përditësimin e fondit të bibliotekës (fizik dhe online) si dhe shkallën e shfrytëzimit të saj.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi IV.4



Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se Sektori i Sekretarisë Mësimore dhe Shërbimit për Studentët, në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve, është struktura që administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi.</p> <p>Gjatë takimit me sekretarinë GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen fizike të dy studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” dhe konstatoi plotësinë e tyre si dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Përveç dokumentacionit dhe arkivës letër, deri në vitin 2022 pranë UBT është përdorur platforma ESSE3, një shërbim software për menaxhimin e proceseve akademike dhe administrative të universiteteve i ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH). Prej vitit 2022 pranë UBT po përdoret platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” realizohet nga disa struktura në varësi të natyrës së informacionit. Departamenti i Financë-Kontabilitetit menaxhon dokumentacionin lidhur me aktivitetin mësimor dhe kërkimor të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Juridike administron dosjet e plota personale të të gjithë personelit të UBT, ndërsa Drejtoria e Ekonomike dhe Financës administron informacionin lidhur me kategoritë, nivelet e ngarkesës, pagesat etj. Informacioni në dosjet përkatëse përditësohet rregullisht për</p>



	<p>të reflektuar ndryshimet e ndodhura në kualifikime, pozicione etj.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor të Tiranës (UBT), miratuar 28.07.2021.pdf; Aneks I.4. Rregullorja e Drejtorise së Menaxhimit të Burimeve Njerezore dhe Pagave, Dhjetor 2018.pdf; https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA, si dikur platforma ESSE3, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë UBT: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjithashtu, GVJ konstatoi përdorimin e aplikacionit Google Sites me faqet individuale web të pedagogëve dhe faqen zyrtare web të UBT, për shkëmbim informacioni me studentët. Në këto faqe web, lehtësisht të përdorshme nga të gjithë të interesuarit, jepen informacione të detajuara lidhur me lëndët që mbulon secili pedagog në programe të ndryshme të studimit në UBT (syllabuse, prezantime të leksioneve në powerpoint, materiale ndihmëse, informacione mbi detyrat e kursit, detyrimet e tjera lidhur me programin mësimor etj).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UBT garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.25 Manual i përdorimit të platformës Pitagora.PDF; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të UBT publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Pjesa e informacionit në gjuhën angleze ishte në proces ndërtimi/përditësimi.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; https://www.ubt.edu.al/fea]</p>

paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.									
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë UBT. - Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UBT. - Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, broshura të ndryshme promovuese të UBT publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet. 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove të njësisë bazë sipas programeve apo cikleve të studimit por vetëm në nivel universiteti dhe për periudha vjetore që përkojnë me vitin buxhetor.</p> <p>Por, GVJ konstatoi se në nivel njësie kryesore, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike & Financës dhe Drejtorinë e Fondeve & Investimeve, hartohet një relacion për realizimin e buxhetit mbi baza vjetore dhe një planifikim për vitin pasardhës për secilin fakultet.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.9 Relacion per realizimin e buxhetit per vitin 2021 dhe planifikimi per vitin 2022, FEA.PDF; vizita në institucion]</p>



Kriteri 2. Plani I financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.

UBT është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas Statutit të UBT, projektbuxheti i vitit pasardhës hartohet nga Rektorati në përputhje me propozimet e bëra në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti. Pas vlerësimit nga Senati Akademik projektbuxheti miratohet nga Bordi i Administrimit i UBT.


Në takimet me drejtuesit e FEA dhe me stafin akademik të programit, GVJ konfirmoi se departamenti dhe fakulteti si pjesë të analizës vjetore përfshijnë edhe propozimet për parashikime financiare në funksion të programeve të studimit lidhur me investime në pajisje, infrastrukturë, pasurimin e bibliotekës etj.

Gjithashtu, GVJ konstatoi se në relacionin vjetor për realizimin e buxhetit & planifikimin për vitin pasardhës për secilin fakultet prezantohen ndryshimet në infrastrukturë dhe analizohen shpenzimet të klasifikuara kryesisht sipas natyrës së tyre (pagat dhe sigurimet sipas kategorive orë të planifikuara dhe mbingarkesa, etj; shpenzimet operative; bursat për studentët; investimet etj), ndërsa analiza e të ardhurave i referohet burimeve kryesore të parashikuara të financimit (tarifave të shkollimit nga studentët dhe kompensimit nga buxheti i shtetit për tarifatat dhe bursat dhe pjesa e tjetër e grantit vjetor të parashikuar sipas ligjit për buxhetin e vitit). Relacioni mbyllet me disa sugjerime lidhur me vijimin e procesit të decentralizimit financiar në nivel Fakulteti, të nisur tashmë një vit më parë.

Referuar dokumentit të paraqitur, GVJ gjykon se vlerat e parashikuara për fondin e kërkimit dhe për libra e publikime për vitin 2022 janë në nivele modeste.

[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor të Tiranës (UBT), miratuar 28.07.2021.pdf; Aneks II.9 Relacion për realizimin e buxhetit për vitin 2021 dhe planifikimi për vitin 2022, FEA.PDF; vizita në institucion]

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Sipas Statutit, kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UBT. Kjo strukturë zhvillon aktivitetin në përputhje me Ligjin nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Gjithashtu UBT si institucion buxhetor është objekt i auditimit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi dy vjeçar, por në nivel njësie kryesore, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike & Financës dhe Drejtorinë e Fondeve & Investimeve, hartohet një relacion për realizimin e buxhetit mbi baza vjetore dhe një planifikim për vitin pasardhës për secilin fakultet. Gjithashtu, në raportet e analizës vjetore në nivel institucioni analizohen të ardhurat dhe shpenzimet mbi bazë viti buxhetor dhe bëhet edhe një analizë krahasuese e realizimit të tyre kundrejt shumave të buxhetuara më parë.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor të Tiranës (UBT), miratuar 28.07.2021.pdf; Aneks II.9 Relacion për realizimin e buxhetit për vitin 2021 dhe planifikimi për vitin 2022, FEA.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UBT është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UBT janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e MFE shpërndahen në formë granti për politikën e zhvillimit të UBT, për mësimdhënien dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga UBT bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.</p>




	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se për periudhën 2021-2023 ecuria e të ardhurave të realizuara paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Viti 2021 rreth 67% fonde të grantit qendror dhe 33% fonde nga tarifat për dhe gjatë shkollimit; ▪ Viti 2022 rreth 72% fonde të grantit qendror dhe 28% fonde nga tarifat për dhe gjatë shkollimit; ▪ Viti 2023 (parashikim) rreth 72% fonde të grantit qendror dhe 28% fonde nga tarifat për dhe gjatë shkollimit. <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT), miratuar 28.07.2021.pdf; Aneks II.9 Relacion per realizimin e buxhetit per vitin 2021 dhe planifikimi per vitin 2022, FEA.PDF; Aneks IV. Tabelat permbledhese te RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</p>
--	---

Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe bën analiza financiare përshkruese në nivel njësie kryesore por jo në nivel njësie bazë apo sipas programeve/cikleve të studimit. - Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UBT dhe auditimit të jashtëm nga KLSH. - UBT si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.
--------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UBT, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</p> <p>Barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantohej edhe nga kërkesat (nenet) specifike të statutit (<i>nenet 3 & 54</i>) dhe rregullores së UBT (<i>nenet 2, 40 & 95</i>), të rregullores së FEA (<i>nenet 3 & 95</i>) dhe të rregullores së programit të studimit (<i>neni 9</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT); Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT); Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA); Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim; https://www.ubt.edu.al/master; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Lidhur me pranimin e studentëve të rinj, GVJ konstatoi se UBT harton dhe publikon kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim sipas secilit program dhe cikël studimesh, çdo vit dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Aktualisht, pranimi në programin e studimit "Master Profesional në Kontabilitet & Auditim" është i mundur për studentët që zotërojnë një diplomë të Ciklit të Parë të studimeve pranë një IAL brenda ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga MAS), si dhe plotësojnë kriterin e meritës dhe kriterin e rëndësisë të propozuar dhe miratuar për vitin akademik në përputhje me kuotat e përcaktuara nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit.</p> <p>Rregullorja e FEA parashikon se kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi propozohen nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe miratohen nga FEA</p>

	<p>në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Pas miratimit të kriterëve të pranimit në nivel universiteti nga Senati Akademik i UBT, vijohet me publikimin e tyre nga FEA dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.15 Propozim i kriterëve për pranimin e studentëve BCH dhe MP 2020-2023.pdf; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim; https://www.ubt.edu.al/master; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi dhe nga faqja zyrtare web e UBT, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se Departamenti i Financë-Kontabilitetit luan një rol mjaft aktiv në informimin e të gjithë të interesuarve në lidhje me UBT, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to. Çdo vit akademik, në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Shërbimeve Mësimore & Studentëve zhvillohen aktivitete informuese, si dhe përditësohet faqja zyrtare web e UBT me informacion mbi programet e studimit, strukturën e tyre, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve, modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në Kontabilitet Auditim; https://www.ubt.edu.al/master; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i UBT nuk ka parashikime specifike për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, por respekton kuadrin ligjor në fuqi dhe Udhëzimet e MAS.</p> <p>Gjithashtu, në kuadrin rregullator të UBT parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS, pa vendosur kriteret e tjera specifike.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për</p>	




përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	[Referenca: Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT); Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT); Aneks II.15 Propozim i kriterëve për pranimin e studentëve BCH dhe MP 2020-2023.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional Kontabilitet Auditim]			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UBT, respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me politikën e ndihmës/bursave për shtresat në nevojë (përjashtim me 50% nga tarifa vjetore e shkollimit) dhe për të rritur cilësinë në programet e tij të studimit (bursa për studentët e shkëlqyer). [Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; vizita në institucion]			
Konkluzione	GVJ konstaton se: <ul style="list-style-type: none"> - Në kuadrin rregullator të UBT parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimin të studentëve në programet master, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. - Kriteret dhe kuotat e pranimin të studentëve bëhen publike nga UBT përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e studimeve master. - UBT respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave, shtresave në nevojë dhe kandidatëve nga shtete të tjera. - UBT respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me politikën e ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për studentët cilësorë. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UBT, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.</p> <p>Konkretisht, GVJ konstatoi që kriteret lidhur me pranimin e studentëve në programet e studimit, regjistrimin e studentëve, kushtet e kalimit në vitet pasuese deri në diplomim, transferimi i krediteve dhe ekuivalentimi i moduleve etj janë pjesë e Rregullores së UBT për Studimet Universitare të publikuar në faqen web zyrtare të UBT, përveçse janë përfshirë në Rregulloren e FEA dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu studentët e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e regjistrimit pranë UBT, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik dhe sekretaria e Departamentit Financë-Kontabilitet, nga specialistët e Sektorit të Sekretarisë Mësimore dhe Shërbimit për Studentët, si dhe nëpërmjet platformës PITAGORA.</p> <p><i>GVJ konstatoi një mospërputhje në numrin e krediteve të nevojshme për të kaluar në vitin e dytë të këtij programi studimi (30 kredite të parashikura në Rregulloren e programit të studimit kundrejt 25 krediteve në Rregulloren e UBT) prandaj rekomandon harmonizimin e parashikimeve në kuadrin rregullator të UBT lidhur me këtë aspekt.</i></p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.25 Manual i perdorimit te platformes Pitagora.PDF; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i FEA.PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim.PDF; https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje</p>	<p>Sipas kuadrin rregullator të UBT, vlerësimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve, me qëllim vazhdimin e studimeve</p>



<p>me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>pranë UBT e bën Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve, një komison <i>ad hoc</i> me përfaqësues nga çdo departament i kryesuar nga Zv. Dekani për mësimin në Fakultetin që pranon studentin (<i>neni 72</i>). Në Rregulloren FEA (<i>nenet 75-80</i>) dhe në Rregulloren e departamentit (<i>nenet 63-65</i>) parashikohen edhe kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT); Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i FEA .PDF; Aneks III.1 Rregullore e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në faqet web të pedagogëve (në platformën google site) dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim”, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar edhe lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi.</p> <p>Në përputhje me rregulloren e FEA, rregulloren e programit të studimit dhe brenda semestrit të parë të vitit të akademik, Departamenti i Financë-Kontabilitetit njofton të gjithë studentët e interesuar rreth procedurës së diplomimit, me provim apo mbrojtje të një punimi diplome për studentët me mesatare 6.5 e sipër. Në rastin e diplomimit me provim, departamenti përgatit një program provimi gjithëpërfshirës me tematika nga fushat kryesore të programit të studimit i cili pasi miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i FEA, publikohet në faqen zyrtare web të FEA. Në rastin e një punimi diplome, fusha e punimit përcaktohet në përputhje me fushat e studimit që mbulon Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili kujdeset për të respektuar edhe kërkesat e studentëve lidhur me zgjedhjen e temës dhe udhëheqësit. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe e çdo detyrimi financiar ndaj UBT, është kusht i domosdoshëm për të vijuar me procesin e diplomimit.</p>



	[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit (FEA); Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim; Aneks III.13 Paketa orientuese e diplomimit.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UBT, GVJ konstatoi se çdo fillim viti akademik, Departament i Financë-Kontabilitetit në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Shërbimeve Mësimore & Studentëve zhvillon aktivitete informuese mbi programet e studimit, si dhe kontribuon në përditësimin e faqes zyrtare web e UBT me informacion udhëzues mbi programet e studimit, strukturën, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të tyre.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstatoi se në fillim të vitit akademik Qendra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me departamentet përkatëse, përgatit dhe përditëson fletëpalosje, udhëzues dhe materiale të tjera informuese mbi programet e studimit të vendosura në mjediset e UBT, si dhe promovon programet e studimit në faqen zyrtare web të UBT, në rrjetet sociale dhe në takime me grupe të ndryshme interesi.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks II.10 Plan veprimi per vitin akademik 2022-2023.PDF; https://www.ubt.edu.al/pranime-regjistrime; vizita në institucion]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. - UBT vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit. - UBT merr pjesë dhe organizon aktivitete informuese për studentët. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” informohen nga pedagogët përkatës, strukturat e Drejtorisë së Shërbimeve Mësimore & Studentëve dhe faqja zyrtare web e UBT për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese si fletëpalosje dhe broshura të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të vendosura në mjediset e UBT dhe në faqen zyrtare web të institucionit. Përmes hapësirës së dedikuar të secilit pedagog të angazhuar në programin e studimit, në faqen web të UBT, studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks III.1 Rregullore e studimit te ciklit te dyte, Master Profesional, ne Kontabilitet Auditim; https://www.ubt.edu.al/fea; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) ishte struktura që kujdesej kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit në fund të ciklit të studimeve.</p> <p>Nga takimi me përfaqësuesin e kësaj strukture, rezultoi se QKA në bashkëpunim edhe me departamentin e Financë-Kontabilitetit, informon, orienton dhe mbështet studentët e këtij programi studimi, duke krijuar mundësi për realizimin e praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, duke lehtësuar komunikimin me tregun e punës si edhe duke ndjekur ecurinë e tyre pas diplomimit. Panairi i Karrierës është një nga aktivitetet</p>


	<p>kryesore që realizon QKA në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të UBT, për t'u dhënë mundësi të gjithë studentëve të UBT të familjarizohen me tregun e punës dhe kërkesat e tij. Gjithashtu, prej disa vitesh, pranë UBT përdoret edhe platforma GRADUA, ku përmes regjistrimit studentët mund të informohen mbi tregun e punës.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.17. Raport Panairi i Karrieres, 2022.PDF; Aneks I.18. Raport Performanca e QKA 2019-2020.PDF; https://www.ubt.edu.al/fea; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se Sektori i Sekretarisë Mësimore dhe Shërbimit për Studentët, Sektori i Karrierës dhe Alumni, si dhe pedagogët e Departamentit të Financë-Kontabilitetit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet faqes web zyrtare të UBT dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera të UBT. Gjithashtu studentët, sipas programit të studimit, mund të konsultojnë orarin mësimor, grafikun dhe rezultatet e provimeve si edhe materialet e postuara nga pedagogët në faqet tyre individuale të integruara në faqen zyrtare të UBT.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; https://www.ubt.edu.al/kampusi-i-ubt; https://www.ubt.edu.al/grafiku-i-provimeve; vizita në institucion]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <p>- Informimi i studentëve mbi organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet në takimet informuese me strukturat përkatëse para dhe gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve, si dhe përmes publikimit të informacionit në ambientet e UBT, në faqen zyrtare në internet dhe në rrjetet sociale.</p>

	<p>- <i>Departamenti i Financë-Kontabilitetit</i> vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit.</p> <p>- <i>Struktura e Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA)</i> në bashkëpunim me Departamentin e Financë- Kontabilitetit kujdesen për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi.</p> <p>- <i>Informimi në distancë</i> realizohet edhe përmes faqes web zyrtare të UBT dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Konkretisht, Drejtoria e Shërbimeve Mësimore & Studentëve (e organizuar në tre sektorë: Sekretaria Mësimore & Shërbimet, Karriera & Alumni, Statistika) në varësi të zv/Rektorit për mësimin është struktura që në bashkëpunim edhe me Departamentet përgjegjëse, administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	Gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me



<p>zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.</p> <p>Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="571 392 1369 678"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Transferime</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>62 studentë</td> <td></td> <td>39 studentë</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>53 studentë</td> <td>2 studentë</td> <td>41 studentë</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>52 studentë</td> <td></td> <td>në proces</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe 3 largime (çregjistrime). Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT); Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i FEA.PDF; Info shtesë 1. Tabela nr 21.PDF; vizita në institucion]</i></p>	Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Të diplomuar	2020-2021	62 studentë		39 studentë	2021-2022	53 studentë	2 studentë	41 studentë	2022-2023	52 studentë		në proces
Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Të diplomuar														
2020-2021	62 studentë		39 studentë														
2021-2022	53 studentë	2 studentë	41 studentë														
2022-2023	52 studentë		në proces														
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UBT. Sektori i Sekretarisë Mësimore & Shërbimit për Studentët kujdeset drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (regjistrat e sekretarisë mësimore, procesverbalet e provimeve & dosjet personale të studentëve) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm informatik PITAGORA/ESSE3). Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT); Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i FEA.PDF; vizita në institucion]</i></p>																



<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sektori i Sekretarisë Mësimore & Shërbimit për Studentët i UBT është strukturë në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mësimore & Studentëve dhe zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Financë-Kontabilitetit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare), si dhe kalueshmërinë sipas lëndëve dhe programeve të studimit. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit për vitin akademik, e cila mbyllet me problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësime.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjithashtu, Departamenti i Financë-Kontabilitetit bashkëpunon me Sektorin e Karrierës & Alumni (QKA) për vlerësimin e të diplomuarve dhe performancës së sistemit universitar, si dhe lehtësimit të procesit të rekrutimit nga punëdhënësit.</p> <p>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Info shtesë; 5. Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; 6. Rregullore e Brendshme e Departamentin FK.PDF; vizita në institucion]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. - Sistemi i brendshëm i informacionit i UBT mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. - Departamenti i Financë-Kontabilitetit në bashkëpunim me sektorin e Karrierës & Alumni analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se UBT në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundur të ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti e në nivel Universiteti, si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatit Akademik të UBT, në Komisionet e Përhershme dhe në Bordin e Administrimit të UBT.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstatoi se në statutin e UBT dhe rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur me mandat 2-vjeçar në një proces transparent. <i>[Referenca: : 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT); Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT); Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit; Aneks II.11 Vendim i Dekanit të FEA-s për GVB të akreditimit të programit MPKA.PDF; vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të garantuara nga statuti dhe rregulloret e UBT, GVJ konstatoi se aktualisht institucioni përdor në fund të çdo semestri edhe pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor, stafin akademik, si dhe infrastrukturën e UBT. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. Rezultatet e pyetësorëve janë objekt diskutimi në të gjitha strukturat e UBT dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerren duke filluar që nga departamenti. <i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.19 Analiza e pyetësorit, AUT.pdf; Aneks I.19.1 Pyetësori On-Line i Studenteve.PDF; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit; Aneks II.14 Format Pyetësori</i>

	<i>per Vleresimin e Procesit Mesimor.PDF; Info shtesë; 5. Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	<p>GVJ konstatoi se Rregullorja e UBT, Rregullorja e FEA dhe Rregullorja e Programit të Studimit, parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, deri në 48 orë nga marrja e rezulttit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Dekanit të Fakultetit që sëbashku me përgjegjësën e Departamentit të Financë-Kontabilitetit ndjek procedurën e parashikuar në kuadrin rregullator për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe marrjen e masave (në rast nevojë) për një datë të re provimi, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Dekanati mban një regjistër për të gjitha ankesat e depozituara nga studentët dhe vendimet e marra për zgjidhjen e tyre (nenin 66 i Rregullores së UBT).</p> <p>Gjithashtu studentët në fund të çdo semestri, mund të përdorin edhe pyetësorët përkatës për të shprehur mendimin e tyre lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p><i>[Referenca: : Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT); Aneks I.19.1 Pyetësor On-Line i Studenteve.PDF; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit; Aneks III.1 Rregullore e studimit, Master Profesional, Kontabilitet Auditim; vizita në institucion]</i></p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Komisionet e Përhershme, në Bordin e Administrimit si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. - GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe pyetësorin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. - Kuadri rregullator i UBT, parashikon të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin në provim.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin dhe rregulloret e UBT parashikohen qartë procedurat dhe strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sektori i Sekretarisë Mësimore & Shërbimeve për Studentë dhe Sektori i Karrierës & Alumni (QKA) në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mësimore & Studentëve. Këto struktura funksionojnë si njësi ndihmëse të Rektoratit me lidhje të drejtpërdrejtë me Zëvendës-Rektorin për Mësimin dhe Dekanët e Fakulteteve të UBT.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Konkretisht, këto struktura në bashkëpunim me njësitë bazë të UBT:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor; ▪ garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe ▪ kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët. <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranës (UBT).pdf; Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranës (UBT).pdf; Aneks I.18. Raport Performanca e QKA 2019-2020.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, organigramës dhe rregulloreve të UBT, rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Sektori i Karrierës & Alumnit (QKA) dhe zyrat e Karrierës pranë çdo Fakulteti të UBT. Në takimin me përfaqësuesin e QKA, gjatë vizitës në</p>



<p>në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj strukture në bashkëpunim edhe me strukturat/zyrat e tjera të UBT fokusohej në promovimin e programeve të studimit të UBT përmes takimeve & informacioneve orientuese tek studentët potencialë, në ofrimin e këshillimit për zhvillimin e karrierës të studentëve aktualë të UBT (hartimi i CV & letrës së motivimit, përgatitja e intervistës, orientimi për praktikën profesionale), si dhe në gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve (mbështetja e Alumni UBT dhe Bordit të tij).</p> <p>Struktura e QKA zhvillon aktivitetin e saj bazuar në planin vjetor të punës të miratuar ku parashikohen aktivitetet e nevojshme, si dhe harton një raport vjetor mbi performancën e saj.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranes (UBT).pdf; Aneks I.18. Raport Performanca e QKA 2019-2020.PDF; Info shtesë 8 Plan Pune 2022-2023_QKA.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se që prej vitit 2017, UBT është pjesë e projektit GRADUA, të mbështetur nga programi Erasmus+ “Ndërtim Kapacitetesh për Arsimin e Lartë”. Ky projekt ka krijuar një platformë të integruar informacioni në shërbim të studentëve dhe të tregut të punës që synon lehtësimin e procesit të rekrutimit nga punëdhënësit përmes ofrimit të një instrumenti unifikues për vlerësimin e të diplomuarve dhe të performancës së sistemit universitar. Mbi të dhënat e platformës është hartuar një raport i profilit të të diplomuarve të UBT.</p> <p>Gjithashtu, struktura e QKA përmes pyetësorit online, realizon gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe harton një raport me rezultatet e punësimit të studentëve të UBT.</p> <p>Këto raporte u vihen në dispozicion të gjitha strukturave të UBT, që nga njësia bazë, si dhe bëhen pjesë e analizave vjetore të tyre.</p> <p>Në hapësirën e dedikuar të faqes zyrtare web të UBT, publikohen aktivitetet e realizuara nga QKA si Panairi i Karrierës dhe dokumenta si udhëzuesi i aplikimit për vende pune.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.11 Raporti GRADUA.PDF; Aneks I.17. Raport Panairi i Karrieres, 2022.PDF; Aneks I.18. Raport Performanca e QKA 2019-2020.PDF; Aneks I.24. Raport</i></p>

	<i>Gjurmimi i Studenteve te UBT-se..PDF; Info shtesë 8 Plan Pune 2022-2023_QKA.pdf; https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni; vizita në institucion]</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Spektori i Sekretarisë Mësimore & Shërbimeve për Studentë, Spektori i Karrierës & Alumni (QKA) i UBT janë strukturuara në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve.</i> - <i>Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Spektori i Karrierës & Alumnit (QKA) dhe zyrat e Karrierës pranë çdo Fakulteti të UBT.</i> - <i>Struktura e QKA përmes pyetësorit online, realizon gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe harton një raport me rezultatet e punësimit të studentëve të UBT.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.

<p>fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Gjatë periudhës së pandemisë janë përdorur gjerësisht platformat Google Classroom & Zoom për mësimdhënien online dhe është hartuar manuali ndihmës i përdorimit. Gjithashtu përmes faqeve personale në site.google, pedagogët komunikojnë materialet mësimore (syllabus, prezantime, detyra etj) tek studentët. Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, ata konfirmuan përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies nga pedagogët në përputhje me parashikimet e syllabuseve të lëndëve si prezantime me powerpoint, prezantimi i rasteve studimore, ndarja në grupe pune etj. Plani Strategjik i UBT i kushton vëmendje ndërmarrjes së hapave për një mësimdhënie interaktive me studentin në qendër, të bazuar edhe në eksperiencën e punës me projekte.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqesor te Tiranës, 2016-2025.pdf; Aneks I.12. Manuali i perdorimit te platformes ZOOM dhe Google Classroom.pdf; Aneks I.16. Manual i cilesise, UBT 2018.PDF; Aneks I.25 Manual i perdorimit te platformes Pitagora.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Drejtoria e Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë (DPSC); ▪ Zv/Rektori për Mësimin; ▪ Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit. <p>Drejtoria e Programeve & Sigurimit të Cilësisë funksion si njësi ndihmëse e Rektoratit të UBT dhe përfshin Sektorin e Programeve & Kurrikulave dhe Sektorin e Sigurimit të Cilësisë. Kjo drejtori e zhvillon aktivitetin në përputhje me rregulloren përkatëse dhe në bashkëpunim me strukturat e mësipërme ndjek të gjitha problemet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UBT me fokus procedurat, aktivitetet dhe dokumentacionin në nivel institucioni (neni 3).</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti (analizat vjetore përkatëse). Gjithashtu, në nivel departamenti mekanizmat e vlerësimit përfshijnë edhe pjesëmarrjen e</p>

	<p>pedagogëve të rinj në leksionet e pedagogëve me eksperiencë, monitorime nga drejtuesi i departamentit etj.</p> <p>GVJ konstatoi se Statuti i UBT parashikon edhe ngritjen e Njësive të Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel Fakulteti me qëllim koordinimin e veprimtarisë së sigurimit të cilësisë sipas programeve të studimit (<i>neni 85</i>). Por GVJ nuk konstatoi ndonjë dokument lidhur me veprimtarinë apo kontributin e realizuar nga NJSC e FEA. Gjithashtu në takimin me përfaqësuesen e Drejtorisë së Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë, GVJ u informua që NJSC-të në nivel Fakulteti raportojnë pranë Zv.Dekanit për Mësimin dhe se komunikimi me ta dhe me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të cilësisë në nivel UBT është i natyrës formale.</p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të qartësojë ndarjen e detyrave mes nënstrukturave të DPSC-së dhe NJSC-ve në nivel Fakulteti, me qëllim evidentimin e veprimtarisë dhe kontributit të secilit në funksion të sigurimit të cilësisë.</i></p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT).pdf; Aneks I.7. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë (DVBSC), Korrik 2021.pdf; Aneks I.8. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI), Dhjetor 2017.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ vlerëson se kuadri rregullator i UBT u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Drejtoria e Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë, në nivel institucioni.</p> <p>Gjithashtu, Rregullorja e UBT, Rregullorja e FEA dhe Rregullorja e Programit të Studimit parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin mësimor dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Dekanit të Fakultetit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.</p>



	<i>[Referenca: : Aneks I.2. Rregullore e Universitetit Bujqesor te Tiranës (UBT); Aneks I.19.1 Pyetsor On-Line i Studenteve.PDF; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit; Aneks III.1 Rregullore e studimit, Master Profesional, Kontabilitet Auditim; vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në përputhje me parashikimet në rregulloren përkatëse, Drejtoria e Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë harton raporte për Rektoratin dhe jep sugjerime mbi ecurinë e punës së saj (raportet mbi pyetësorët e studentëve, zhvillimin e mësimi, ecuria e akreditimit etj). Gjithashtu kjo strukturë bashkëpunon me Zv.Rektorin për Mësimin për hartimin e analizës vjetore të veprimtarisë mësimore të UBT që i prezantohet Senatit Akademik. Këto raporte bëhen pjesë edhe e analizave vjetore që realizohen në nivel departamenti dhe fakulteti.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në takimin e zhvilluar me personelin akademik të këtij programi studimi, gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. <i>[Referenca: Aneks I.7. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorise Vlerësimit te Brendshem & Sigurimit te Cilesise; Aneks I.19 Analiza e pyetesorit.pdf; Info shtesë 5. Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; 9.Analiza mesimore e vitit akademik 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>UBT ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie.</i> - <i>Kuadri rregullator i UBT u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje.</i> - <i>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe UBT.</i> - <i>UBT angazhohet për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, Statutit dhe Rregulloreve të UBT, GVJ konstatoi se procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Përgjegjësia institucionale e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë i takon Drejtorisë së Programeve & Sigurimit të Cilësisë. Në nivel Fakulteti dhe Universiteti organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit & Kërkimit Shkencor me anëtarë të përzgjedhur nga asambleja e personelit akademik si dhe me përfaqësues nga asambleja e studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në planin strategjik të UBT, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, bazuar në analizën SWOT të realizuar në ndihmë të planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë si një kërkesë themelore për rritjen e reputacionit të UBT brenda dhe jashtë vendit. Në këtë dokument identifikohen qartë synimet dhe objektivat, rezultatet e pritshme, si dhe hapat e veprimet e nevojshme për t'u ndërmarrë për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të strukturave dhe gjithë sistemit të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Një tjetër dokument i rëndësishëm, në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë është dhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë, që paraqet: parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë; proceset dhe mekanizmat e monitorimit, vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies & mësimnxënies; vlerësimin e kërkimit shkencor, vlerësimin e shërbimeve për studentët, infrastrukturën dhe menaxhimin në UBT.</p>

	<p><i>Duke vlerësuar angazhimin e UBT në ngritjen e strukturave dhe hartimin e dokumentave strategjikë në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, <u>GVJ rekomandon</u> përditësimin e tyre sidomos përsa i takon emërtimeve të reja të strukturave (drejtorive & sektorëve) në përputhje me ndryshimet e ndodhura dhe të publikuara në organigramën e UBT.</i></p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor te Tiranes.pdf; Aneks I.2. Rregullore e UBT.pdf; Aneks I.3. Plani Strategjik i Universitetit Bujqësor te Tiranes, 2016-2025.pdf; Aneks I.7. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise.pdf; Aneks I.16. Manual i cilesise, UBT 2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vitit 2021, UBT i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore.</p> <p>Konkretisht, me vendimin Nr.59 të Bordit të Akreditimit, datë 16.12.2021 UBT ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 5 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 15.12.2026.</p> <p>Ndërsa për programin e studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” ky është akreditim që kryhet për herë të parë.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.9 Certifikata e Akreditimit te UBT.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të</p>	<p>GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UBT paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti (analizat vjetore përkatëse) ku përfshihen edhe rezultatet e pyetësorëve dhe studimeve gjurmuese. Gjithashtu, në nivel departamenti mekanizmat e vlerësimit përfshijnë edhe pjesëmarrjen e pedagogëve të rinj në leksionet e pedagogëve me eksperiencë, monitorime nga</p>

mira në programin e studimit.	<p>drejtuesi i departamentit etj. GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit me objektiv rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet.</p> <p>[Referenca: Aneks I.2. Rregullore e UBT.pdf; Aneks I.7. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise.pdf; Aneks I.16. Manual i cilesise, UBT 2018.PDF; Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarise mesimore & kerkimore 2020-2021.PDF; vizita në institucion]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në UBT procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. - UBT ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 5 vite akademike. - Programi i studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditim” akreditohet për herë të parë. - Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i UBT parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë. Në mënyrë më specifike Rregullorja e</p>

<p>për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqytjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Programit të Studimit “Master Profesional në Kontabilitet & Auditimi” parashikon rishikimin periodik të programit të studimit (neni 57) përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ngritjes së komisionit ad-hoc për rishikimin me fokus pune elementët përbërës dhe procedurat e PS, si dhe analizën e problematikave të ndeshuara dhe marrjen e masave për vitin pasues. ▪ kontroleve në vazhdimësi të ecurisë mësimore nga Drejtoria e Shërbimeve Mësimore & Studentëve dhe struktura e Zv.Dekanit. <p>Gjithashtu, në nivel universiteti, Drejtoria e Programeve & Sigurimit të Cilësisë ndjek problemet lidhur me mësimin, ngarkesat, mbarëvajtjen e procesit të akreditimit, aspektet formale të përgatitjes së programeve të rinj të studimit për të gjithë ciklet e studimit, si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UBT.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.7. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë Vlerësimit të Brendshëm & Sigurimit të Cilësisë; Aneks III.1 Rregullore e studimit, Master Profesional, në Kontabilitet Auditim.PDF]</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqëruar dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në mbledhjet e departamentit Departamenti i Financë-Kontabilitetit në fund të çdo semestri mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UBT sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Raporti i analizës përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, stafin akademik dhe studentët, menaxhimin e brendshëm dhe veprimtaritë ndihmëse. Për secilin prej këtyre aspekteve evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. Në nivel universiteti, Drejtoria e Programeve & Sigurimit të Cilësisë bashkëpunon me Zv.Rektorin për Mësimin për hartimin e analizës vjetore të veprimtarisë mësimore të UBT që i prezantohet Senatit</p>

	<p>Akademik. Në këtë raport evidentohen qartë objektivat dhe metodologjia e përgatitjes së tij dhe analizohen në nivel universiteti ecuria e vitit akademik lidhur me programet e studimit, procesin mësimor, stafin akademik, studentët, menaxhimin dhe infrastrukturën e UBT. Problematikat e evidentuara për secilin prej këtyre aspekteve shoqërohen me rekomandime dhe plan masash për trajtimin e mangësive dhe përmirësim të mëtejshëm.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Info shtesë 5. Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; 9.Analiza mesimore e vitit akademik 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në takimet me drejtuesin e Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në UBT përdoren procedura formale për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim viti akademik; ▪ në fund të çdo semestri, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies; ▪ monitorime të procesit mësimor & analiza në mbledhjet e departamentit; ▪ pjesëmarrje e pedagogëve të rinj në leksionet e pedagogëve me eksperiencë etj. <p><i>[Referenca: Aneks II.14 Format Pyetesori per Vleresimin e Procesit Mesimor.PDF; Info shtesë 5. Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të</p>	<p>GVJ vlerëson angazhimin e UBT në realizimin e anketimeve online me studentët e diplomuar, e intervistave gjatë aktiviteteve si panairi i karrierës, si dhe hartimin e raporteve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe cilësinë e programeve të studimit që ofron.</p> <p><i>Por, GVJ konstaton se këto raporte nuk janë të dedikuara sipas programeve të studimit (për shkak edhe të numrit relativisht të</i></p>

atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.

ulët të përgjigjeve nga studentët e diplomuar) prandaj rekomandon dokumentimin formal të komunikimit me bashkëpunëtorët e jashtëm, opinioni i të cilëve (si ekspertë të fushave përkatëse) do të ishte me vlerë për përditësimin e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.

[Referenca: Aneks I.11 Raporti GRADUA.PDF; Aneks I.24. Raport Gjurmimi i Studenteve te UBT-se..PDF; vizita në institucion]



Konkluzione

GVJ konstaton se:


- *Kuadri rregullator i UBT parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.*
- *Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës.*
- *UBT përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit				
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se kuadri rregullator



 101

<p>procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në rregulloren e Drejtorisë së Programeve & Sigurimit të Cilësisë (DPSC) përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjithashtu, në Manualin e Cilësisë paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në UBT, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UBT.</p> <p><i>Megjithatë, siç u komentua edhe në Standardet VI.1 dhe VI.2, GVJ rekomandon përditësimin e këtyre dokumentave përsa i takon emërtimeve të reja të strukturave (drejtorive & sektorëve) si dhe qartësimin e ndarjes së detyrave mes nënstrukturave të DPSC-së dhe NJSC-ve në nivel Fakulteti, në funksion të sigurimit të cilësisë dhe në përputhje me ndryshimet e ndodhura dhe të publikuara në organigramën e UBT.</i></p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqesor te Tiranes.pdf; Aneks I.7. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise.pdf; Aneks I.16. Manual i cilesise, UBT 2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se UBT garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. Pranë FEA është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me tre anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p>Në Kodin e Etikës së UBT jepen parimet e etikës akademike dhe publike të detyrueshme për të gjithë, në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, si edhe shprehet qartë angazhimi i UBT për respektimin e integritetit dhe shmangien e diskriminimit</p>



<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>duke adresuar në mënyrë të kujdesshme të gjitha problemet etike të studentëve dhe personelit gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>[Referenca: Aneks I.6. Rregullore e Keshillit të Etikes së Universitetit Bujqësor të Tiranës, Qershor 2022.pdf; Aneks IV. Tabelat përmbledhese të RVB-se (1-22).pdf; vizita në institucion]</i></p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjithashtu, GVJ konstaton se UBT angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UBT dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.14 Lista e marrëveshjeve 2022 _SHKFK dhe KKK.pdf; Aneks I.17. Raport Panairi i Karrierës, 2022.PDF; vizita në institucion]</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator i UBT përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>UBT siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>Përfshirja e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet kryesisht përmes aktiviteteve si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private.</i> 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen zyrtare web të tij të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p> <p>GVJ vlerëson se publikimet në faqen zyrtare web të UBT dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare web të UBT dhe komunikimeve në platformën PITAGORA.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; Aneks I.1. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT).pdf; Aneks II.1 Rregullore e Brendshme, FEA.PDF; Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarisë mesimore dhe kërkimore periudha 2020-2021.PDF; https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>GVJ konstatoi se raportet e analizave të zhvilluara në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti shoqërohen me konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe të problematikave të evidentuara.</p> <p>Në mbledhjet e departamentit, stafi akademik analizon në mënyrë aktive ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjeron rekomandime në përputhje me gjetjet. Në përfundim të diskutimeve në nivel njësie bazë dhe kryesore, si dhe bazuar në propozimet e bëra prej tyre, hartohet në nivel fakulteti plani i veprimit për vitin akademik.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarisë mesimore dhe kërkimore periudha 2020-2021.PDF; Aneks II.10 Plan veprimi për vitin akademik 2022-2023.PDF; Info shitesë: 5.</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>GVJ konstatoi se raportet e analizave të zhvilluara në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti shoqërohen me konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe të problematikave të evidentuara.</p> <p>Në mbledhjet e departamentit, stafi akademik analizon në mënyrë aktive ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjeron rekomandime në përputhje me gjetjet. Në përfundim të diskutimeve në nivel njësie bazë dhe kryesore, si dhe bazuar në propozimet e bëra prej tyre, hartohet në nivel fakulteti plani i veprimit për vitin akademik.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarisë mesimore dhe kërkimore periudha 2020-2021.PDF; Aneks II.10 Plan veprimi për vitin akademik 2022-2023.PDF; Info shitesë: 5.</i></p>

	<i>Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; 9.Analiza mesimore e vitit a kademik 2021-2022.pdf]</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i raporteve të analizës së veprimtarisë në nivel departamentit, fakulteti dhe universiteti, GVJ konstatoi se raportet përfshijnë dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra. Gjithashtu, përfshirja e indikatorëve dhe afateve të realizimit të aktiviteteve sipas strukturave përgjegjëse në planin e veprimit për vitin akademik të hartuar në nivel fakulteti, garanton vlerësimin efektiv të veprimtarive për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: Aneks II.3.1 FEA, Analiza e veprimtarise mesimore dhe kerkimore periudha 2020-2021.PDF; Aneks II.10 Plan veprimi per vitin akademik 2022-2023.PDF; Info shtesë: 5. Analiza e Punes Mesimore-Kerkimore Dep.FK 2021-2022.pdf; 9.Analiza mesimore e vitit a kademik 2021-2022.pdf]</i></p>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Në takimet me drejtuesin e Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin dhe përkushtimin e personelit akademik për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit përmes analizave dhe veprimtarive periodike me pedagogët dhe studentët në funksion të këtij kriteri, përditësimeve të materialeve mësimore, publikimeve në faqen zyrtare web të UBT me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: 0.2 RVB_MPKA.pdf; https://www.ubt.edu.al/rankimi-ne-web; vizita në institucion]</i></p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë të interesuarve. - Publikimet në faqen zyrtare web të UBT dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. - Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e

	<p><i>efektivitetit të aktivitete të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>- UBT angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen 106ctive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Kontabilitet dhe Auditim”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Tradita e pasur dhe eksperiencia institucionale në ofrimin e programeve të studimit në fushat e shkencave ekonomike;
2. Konteksti i disiplinës agrobiznes, si i vetmi Institucion IAL në vendin tonë që ofron këtë ndërthurje mes ekonomisë/biznesit dhe bujqësisë;
3. Cilësia dhe ekspertiza e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
4. Plani mësimor i programit të studimit përmban lëndë të rëndësishme dhe prioritare të fushës, për një formim cilësor të studentëve dhe për t’u mundësuar punësim të shpejtë si dhe njohje e ekuivalentim në rast të studimeve të mëtejshme;
5. Një larmi marrëveshjesh bashkëpunimi që lehtësojnë kryerjen e praktikave profesionale të lidhura me programin e studimit;
6. Projektet kërkimore dhe shkencore si edhe projektet në ngritje kapacitetesh që ndihmojnë dhe pajisin Institucionin në ofrimin e shërbimeve arsimore të pasura dhe cilësore;

b. Pika të dobta:

1. Disa dokumenta strategjikë në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë rezultuan me emërtimet e vjetra të strukturave (drejtorive & sektorëve) si dhe komunikimi mes nënstrukturave të Drejtorisë së Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë (DPSC) dhe Njërive të Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel Fakulteti ishte në nivele minimale; (*Standardi VI.1, Standardi VI.2, Standardi VI.4*)
2. Mungesa e analizave të detajuara lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit; (*Referenca: Fusha IV, Standardi IV.5, kriteri 2*)

Rekomandime

1. Institucioni duhet të përditësojë dokumentat strategjikë në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë sidomos përsa i takon emërtimeve të reja të strukturave (drejtorive & sektorëve) në përputhje me ndryshimet e ndodhura dhe të publikuara në organigramën e UBT;
2. Institucioni duhet të qartësojë ndarjen e detyrave mes nënstrukturave të DPSC-së dhe NJSC-ve në nivel Fakulteti, në funksion të sigurimit të cilësisë dhe në përputhje me ndryshimet e ndodhura në organigramën e UBT;
3. Institucioni duhet të realizojë një analizë të qartë dhe të detajuar lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Accounting and Auditing"

a. Strengths and affirmations:

1. Rich tradition and institutional experience in the provision of study programs in the field of economics;
2. The context of the discipline agribusiness, as the only higher education institution in our country offering this combination of economics/business and agriculture;
3. The quality and the expertise of the academic staff engaged at this study program;
4. The curriculum of the study program includes important and priority subjects of the sector, for a quality education of the students that allows a rapid job placement as well as recognition and equivalence in case of further studies;

5. A variety of cooperation agreements facilitating the carrying out of professional practices related to the study program;
6. The Institution has research and scientific projects, as well as capacity building projects that help and equip it to provide rich and quality educational services;

b. Weaknesses:

1. Some strategic documents related to the internal quality assurance function resulted in old structure names (directorates & sectors) and the communication between the substructures of the Directorate of Programs and Quality Assurance (DPSC) and Quality Assurance Units (NJSC) at the Faculty level was not well formalized; (*Standard VI.1, Standard VI.2, Standard VI.4*)
2. Lack of detailed analysis related to academic and logistical costs according to study programs and/or according to study cycles; (*Standard IV.5, Criteria 2*)

Recommendation

1. The institution should update the strategic documents related to the internal quality assurance function, in particular the new names of the structures (directorates and sectors) should reflect the changes in the UBT organizational chart;
2. The institution should pay attention to the division of duties between the substructures of the DPSC and the NJSCs at the Faculty level with regards to quality assurance and in accordance with changes in the UBT organizational chart;
3. The institution should carry out a clear and detailed analysis regarding the academic and logistical costs according to the study programs or according to the cycle of studies;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X